# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 7008
E premte, 29 shtator 2023
Çmimi 0. 50 €

## Komandanti i FSK-së kërkon që Kosova të anëtarësohet në Kartën e Adriatikut
FAQE 3



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KUVENDI I KOSOVËS ME REZOLUTË DËNON SULMIN TERRORIST NË VERI TË VENDIT FAQE 4

# KOSOVA NXJERR REZOLUTË KUNDËR SULMIT NË VERI, KËRKON HETIM NDËRKOMBËTAR



Kuvendi i Kosovës ka miratuar rezolutën e cila dënon sulmin terrorist serb të 24 shtatorit në veri të vendit në të cilin ka mbetur i vrarë rreshteri i policisë Afrim Bunjaku. Nëpërmjet kësaj rezolute, e cila ka marrë 97 vota të deputetëve, është kërkuar hetim ndërkombëtar për atë se çfarë ka ndodhur në veri. Po nëpërmjet kësaj rezolute është kërkuar nga Qeveria e Kosovës të bashkëpunojë me aleatët ndërkombëtarë, veçanërisht me ShBA-në, për ta fuqizuar edhe më tutje shtetin e së drejtës dhe vlerat euroatlantike

## BE-JA GODET SERBINË: NUK MUND TË BARAZOHEN TERRORISTËT ME VIKTIMAT E TERRORIZMIT



## RAMA NUK TËRHIQET: BE-ja DUHET TA DËNOJË SULMIN NË BANJSKË



## OPINION

### PAS NGJARJEVE NË VERI, A MUND TË IMPONOHET NJË MARRËVESHJE E PANEGOCIUESHME POLITIKE?!
F. 7

Shkruan: Behxhet Sh. SHALA – BAJGORA



### PASVEPRIMI I NJË SKENARI TË NDALUR, POR I PAPËRFUNDUAR! F. 9-10

Analizë nga Hisen BERISHA



## AKTUALE



### TURQIA MBËSHTET KOSOVËN PAS SULMIT TERRORIST NË BANJSKË F. 3

### OSMANI NË DITËN E BOSHNJAKËVE: NDAJMË HISTORINË E PËRBASHKËT TË GJENOCIDIT SERB F. 3

## EKONOMI



### KOSOVA MERR 20 MILIONË DOLLARË KREDI PËR DIGJITALIZIM F. 8

### RAFUNA DHE SZUNYOGU BISEDOJNË PËR KLIMËN E TË BËRIT BIZNES NË KOSOVË F. 8

RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
E-mail: renova@mt.net.mk
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

## Mediet serbe: Zgjedhjet parlamentare në Serbi do të mbahen më 17 dhjetor



BEOGRAD, 28 SHTATOR - Kryeministrja e Serbisë, Ana Brnabiq, ka kërkuar nga ministrat dhe sekretarët e shtetit, që deri në mes të tetorit të miratohen të gjitha dekretet dhe rregulloret që janë në proces pasi, sipas saj, zgjedhjet parlamentare do të mbahen më 17 dhjetor, ka mësuar "N1".

Kujtojmë se presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka thënë të mërkurën mbrëma se zgjedhjet parlamentare, provinciale dhe ato të Beogradit mund të mbahen më 17 dhjetor. "Kam biseduar me disa persona, disa janë për, disa kundër dhe nuk mendoj se është çështje kyçe, por duhet t'i respektoni partitë opozitare. Ata thanë se vendi është në kolaps, se ekonomia është shkatërruar, edhe pse ekonomia është dhjetë herë më e fortë se kur qeverisnin ata. Nuk jam dakord me asgjë. E pranova idenë e tyre dhe jemi gati për zgjedhjet e 17 dhjetorit", ka thënë Vuçiqi.

Kryetari i komunës së Kralevës, Predrag Terziq, ka thënë se ka dhënë dorëheqje nga ajo pozitë. Të njëjtën gjë e kanë bërë edhe kryetarët e komunave të Kuçevës dhe Smederevës, të gjithë anëtarë të Partisë Progresive Serbe. Siç ka mësuar "N1", Terziq ka marrë vendimin për të dhënë dorëheqjen të enjten në mëngjes. Dorëheqjen e ka dorëzuar edhe kryetari i komunës së Smederevës, Jovan Beç, i cili dorëheqjen e ka dorëzuar në zyrën e nëpunësve.

Edhe Kuçova ka mbetur pa njeriun e parë të komunës, për të cilën përmes një komunikate për media e ka njoftuar opinionin presidenti Ivan Rajiçiq.

# Stoltenbergu: Ukraina gradualisht po fiton terren

KIEV, 28 SHTATOR - Forcat ukrainase "gradualisht po fitojnë terren" në kundërofensivën kundër pushtuesve rusë, ka thënë shefi i NATO-s, Jens Stoltenberg, gjatë një vizite të paparalajmëruar në Kiev më 28 shtator, disa orë pasi ushtria ukrainase ka thënë se ka zmbrapsur një valë të madhe të sulmeve me dronë nga Rusia në jug të Ukrainës. "Trupat ukrainase po përballen me luftime të ashpra, por ngadalë po fitojnë terren", ka thënë Stolenbergu në një konferencë të përbashkët për medie me presidentin ukrainas Volodymyr Zelensky.

"Çdo metër që forcat ukrainase rimarrin është metër që Rusia humb... Moska po lufton për deluzione imperialiste", ka thënë Stoltenbergu.

Shefi i NATO-s, po ashtu, ka njoftuar se aleanca ka krijuar kontrata në vlerë prej 2.4 miliardë eurosh për municione të rëndësishme për Kievin, përfshirë edhe 1 miliard euro për furnizime me armë.

Sekretari i Përgjithshëm ka thënë se lidhjet e Ukrainës me aleancën ushtarake perëndimore kurrë nuk kanë qenë më të afërta. "Ukraina tani është më afër NATO-s se kurrë më parë", ka thënë ai.

Gjatë samitit të NATO-s në korrik, liderët e aleancës përmes deklaratës së përbashkët thanë se e ardhmja e Ukrainës është brenda aleancës, por NATO ka thënë se do t'i dërgojë ftesë Kievit për anëtarësim vetëm "kur anëtarët të pajtohen se janë plotësuar kushtet".



Presidenti ukrainas ka kërkuar që aleanca t'i forcojë sistemet e mbrojtjes ajrore të Kievit, pasi Ukraina pret që Rusia t'i rinisë sërish sulmet ndaj ndërtesave të energjisë kur të ftohet moti. "Sekretari i Përgjithshëm u pajtua që të ndërmarrë hapa për të na ndihmuar ne në këtë drejtim, për t'i mobilizuar shtetet anëtare të aleancës", ka thënë Zelensky.

Vizita e Stoltenbergut në Kiev ka ardhur disa orë pasi mbrojtja ajrore e Ukrainës ka njoftuar se ka shkatërruar 34 nga 44 dronët "Shahed", prodhim iranian që Rusia ka lëshuar mëngjesin e 28 shtatorit.

Ushtria ka thënë se Rusia nisi një valë të re të sulmeve me dronë në jug të Ukrainës. Ukraina po vazhdon kundërofensivën e saj në lindje dhe jug të shtetit dhe ushtria raportoi të enjten për 26 beteja të afërta të zhvilluara në rajonin lindor të Donjeckut.

# Gati një mijë persona vdesin nga ethet tropikale në Bangladesh



DHAKA, 28 SHTATOR - Gati një mijë persona kanë vdekur në Bangladesh javët e fundit dhe autoritetet kanë thënë se bëhet fjalë për një prej shpërthimeve më të rënda të etheve tropikale deri më tani. Periudhat jashtëzakonisht të lagshta, me shi, e kanë bërë më të lehtë për mushkonjat që ta bartin virusin e etheve tropikale.

Zyrtarët kanë thënë se vështirë që mund ta mbajnë nën kontroll sëmundjen dhe spitalet veçse janë të stërngarkuara.

Në rastet e rënda, ethet tropikale përcillen me gjakderdhje që mund të çojë në vdekje. Simptomat kryesore janë kokëdhembja dhe dhimbjet e muskujve dhe nyjave.

Ethet tropikale janë endemike në vendet tropikale dhe shpërthimet ndodhin në zonat urbane me higjienë të dobët, çka e mundëson shumimin e mushkonjave. Kjo sëmundje ka qenë dikur sezonale në Bangladesh, mirëpo për shkak të motit të nxehtë dhe periudhave të lagshta, ajo është duke u përhapur shumë më shpesh.

Zyrtarë të shëndetit publik besojnë se vala aktuale e infektimeve e ka zënë shtetin në befasi, pasi është shkaktuar nga një mutacion më i fuqishëm i virusit. Mjekët janë duke thënë se gjendja e pacientëve me ethe tropikale është duke u përkeqësuar shumë më shpejt në krahasim me të kaluarën.

## Akullnajat zvicerane humbin 10 për qind të masës brenda dy vjetëve

BERNË, 28 SHTATOR - Akullnajat zvicerane kanë përjetuar humbje ekstreme të masës – rreth 10 për qind në dy vjetët e fundit, ka thënë Komisioni zviceran për vëzhgim të Kriosferës, me seli në Gjenevë. "Një vit ekstrem përcillet me një tjetër. Akullnajat në Zvicër kanë humbur 6 për qind të masës më 2022. Megjithatë, më 2023 është regjistruar edhe një humbje tjetër prej 4-përqindësh, çka përbën zvogëlimin e dytë më të madh prej fillimit të matjeve. Akullnajat zvicerane janë duke u shkrirë me ritëm të shpejtë. Shpejtësia është dramatike, pasi sasia e akullit të shkrirë në vetëm dy vjet është e ngjashme me periudhën 1960-1990", ka thënë Komisioni zviceran për vëzhgim të Kriosferës.

Si arsye për një shkrirje të tillë është përmendur sasia e vogël e reshjeve të borës në periudhën 2022-23 dhe temperaturat tejet të larta në verë. Një pjesë e akullnajave është zhdukur plotësisht. Shkrirje është regjistruar edhe në luginat Valais dhe Engadin, ku akulli gjendet në lartësi prej mbi 3 200 metrave. Mesatarja e humbjes së akullit në këtë zonë ka shkuar në tri metra.



EPOKA E RE

Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# Osmani në Ditën e Boshnjakëve: Ndajmë historinë e përbashkët të gjenocidit serb

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 28 SHTATOR - Në Ditën e Boshnjakëve, presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, u ka ndarë mirënjohje dhe dekorata disa personaliteteve të shquara të këtij komuniteti për kontributin e dhënë për shtetndërtim.

Osmani ka thënë se populli i Kosovës është mirënjohës ndaj komunitetit boshnjak, me të cilin ndan "një histori të përbashkët të dhimbjeve, vrasjeve, persekutimeve, deri te gjenocidi i kryer kundër nesh". "Është një mundësi e shkëlqyer për t'i vlerësuar edhe një herë të arriturat tuaja, rolin tuaj në procesin e lirisë e të pavarësisë dhe shtetndërtimit të Kosovës dhe ndërtimin e një shoqërie demokratike në vendin tonë. Populli i Kosovës ju është mirënjohës për kontributin tuaj historik për promovimin e vlerave tona të përbashkëta demokratike. Boshnjakët sot janë pjesë e rëndësishme e jetës demokratike të vendit tonë. Ne ndajmë një histori të përbashkët të dhimbjeve, vrasjeve, persekutimeve deri tek gjenocidi i kryer kundër nesh", ka thënë Osmani.

Ajo ka thënë se synimet hegjemoniste të Serbisë nuk po ndalen ende, por se Kosova nuk do të zmbrapset asnjëherë për vendosjen e rendit dhe ligjit. "Synimet hegjemoniste të Serbisë nuk po ndalen as sot siç ndodhi edhe me sulmin e fundit terrorist, akti i agresionit kundër vendit tonë ku u vra rreshteri policor Afrim Bunajku. Për vendosje të rendit e ligjit dhe të mbrojtjes së sovranitetit nuk do të zmbrapsemi asnjëherë. Kosova është shtet përgjithmonë dhe shtëpi e të gjithëve. E tillë do të mbetet përherë", ka thënë Osmani.

Me këtë rast, ajo për ish-luftëtarin e UÇK-së, Nehat Demiri, ka ndarë çmimin post-mortem "Urdhri i Lirisë".

Me dekorimin post-mortem është



dekoruar edhe akademiku Jashar Rexhepagiq. Ai është dekoruar me medaljen presidenciale të meritave për kontributin në arsimin dhe promovimin e identitetit boshnjak në Kosovë.

Me dekorimin post-mortem është dekoruar edhe Nuredin Jonuzin. Po ashtu, atij i është ndarë medalja e meritave për kontribut të lartë për arsimin, kulturën dhe promovimin e identitetit kombëtar të komunitetit boshnjak në Kosovë.

Presidentja ka dekoruar post-mortem edhe Alija Gjogoviqin me medaljen e meritave për kontribut të lartë për arsimin, kulturën dhe promovimin e identitetit kombëtar të komunitetit boshnjak në Kosovë.

# Komandanti i FSK-së kërkon që Kosova të anëtarësohet në Kartën e Adriatikut

SHKUP, 28 SHTATOR - Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Bashkim Jashari, ka thënë se është koha që Kosova të anëtarësohet në Kartën e Adriatikut. Ai këtë deklaratë e ka dhënë në Konferencën e Shefave të Mbrojtjes së Kartës së Adriatikut - ShBA, e cila po mbahet në Shkup.

Gjatë fjalimit të tij, Jashari ka folur edhe për sulmin terrorist në veri të vendit më 24 shtator, ku kërkoi dënimin për ato shtete që përkrahin sulme të tilla.

"Gjeneral Jashari foli për sulmet e ndodhura në veri të Kosovës dhe për faktin që ato janë kërcënim për stabilitetin e Kosovës dhe të rajonit. Gjenerali ritheksoi që gjëra të tilla nuk bën të përsëriten dhe shtetet të cilat i përkrahin ato duhet ta marrin dënimin e



merituar. Në fund, gjeneral Jashari zyrtarisht u deklaroi pjesëmarrësve që ka ardhur koha që Kosova të bëhet anëtare e plotë e Kartës së Adriatikut", ka njoftuar Ministria së Mbrojtjes.

Komandanti i FSK-së me delegacionin e tij ka realizuar takime bilaterale me delegacionin amerikan të prirë nga gjeneral Christopher Cavoli, komandant i Forcave Amerikane për Evropë (EUCOM).

"Gjatë takimit gjeneral Jashari prezantoi të arriturat e FSK-së dhe falënderoi gjeneralin Cavolin për mbështetjen dhe partneritetin në fushën ushtarake mes dy vendeve. Po ashtu, u diskutua për situatën e sigurisë në vendin tonë dhe për sfidat rreth saj", ka njoftuar Ministria e Mbrojtjes.

Gjeneral Cavoli e ka përgëzuar gjeneral Jasharin për lidershipin e tij, njëherësh ka ritheksuar se ShBA-ja do të vazhdojë ta mbështesë FSK-në në rrugën e zhvillimit të kapaciteteve ushtarake dhe atyre të mbrojtjes.

# Turqia mbështet Kosovën pas sulmit terrorist në Banjskë

PRISHTINË, 28 SHTATOR - Zëvendëskryeministri parë i Kosovës, Besnik Bislimi, ka pritur në takim ambasadorin e Turqisë në Prishtinë, Sabri Tunç Angılı. Me këtë rast, Qeveria e Kosovës ka njoftuar se ambasadori Angılı ka thënë se Turqia e mbështet Kosovën plotësisht pas sulmit terrorist në Banjskë të Zveçanit, teksa ka shprehur ngushëllimet e tij për familjen e heroit Afrim Bunjaku. "Fillimisht, ambasadori Angılı shprehu ngushëllimet e tij për familjen e të ndjerit Afrim Bunjaku, policinë dhe popullin e Kosovës. Ai tha se Turqia e mbështet Kosovën në këtë moment të vështirë pas këtij sulmi. Zëvendëskryeministri Bislimi e falënderoi ambasadorin për mbështetjen dhe mesazhin e tij. Ai e informoi atë më tej mbi sulmin terrorist të së dielës, duke thënë se ishte i orkestruar e organizuar nga Beogradi zyrtar", ka njoftuar qeveria.

Në këtë takim palët kanë biseduar edhe për mundësitë e thellimit të marrëdhënieve bilaterale dhe rritjen e bashkëpunimit në mes të Kosovës dhe Turqisë.





KUVENDI I KOSOVËS ME REZOLUTË DËNON SULMIN TERRORIST NË VERI TË VENDIT

# Kosova nxjerr rezolutë kundër sulmit në veri, kërkon hetim ndërkombëtar

Kuvendi i Kosovës ka miratuar rezolutën e cila dënon sulmin terrorist serb të 24 shtatorit në veri të vendit në të cilin ka mbetur i vrarë rreshteri i policisë Afrim Bunjaku. Nëpërmjet kësaj rezolute, e cila ka marrë 97 vota të deputetëve, është kërkuar hetim ndërkombëtar për atë se çfarë ka ndodhur në veri. Po nëpërmjet kësaj rezolute është kërkuar nga Qeveria e Kosovës të bashkëpunojë me aleatët ndërkombëtarë, veçanërisht me ShBA-në, për ta fuqizuar edhe më tutje shtetin e së drejtës dhe vlerat euroatlantike

EPOKA E RE **Lirim GECI**

PRISHTINË, 28 SHTATOR - Kuvendi i Republikës së Kosovës e ka miratuar të enjten një rezolutë, e cila e dënon sulmin ndaj Policisë së Kosovës në Banjskë të Zveçanit. Nëpërmjet kësaj rezolute është kërkuar një hetim ndërkombëtar për Serbinë dhe rolin e saj në sulmin e 24 shtatorit, ku ka mbetur i vrarë rreshteri i policisë, Afrim Bunjaku, i cili është shpallur hero i Kosovës.

Rezoluta është miratuar me 97 vota për, asnjë votë kundër dhe asnjë abstenim.

Në paraqitjen të rezolutës, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka thënë se ky institucion e dënon sulmin ndaj Policisë së Kosovës në termat më të ashpër. "Sulmin terrorist të organizuar nga Republika e Serbisë mbi Policinë e Kosovës dhe kërkon nga komuniteti ndërkombëtar që ta ushtrojë ndikimin e tij për ta ballafaquar Serbinë me rolin e saj në raport me organizimin dhe çfarëdo mbështetjeje që i ka bërë grupit terrorist për sulmin në veri të Republikës së Kosovës", ka thënë Konjufca.

Hetimet ndërkombëtare ndaj Serbisë janë kërkuar "lidhur me aktivitetet terroriste dhe vazhdimin e ekzistencës së kampeve stërvitore të grupeve terroriste në kampin e Serbisë".

Në rezolutë është vlerësuar edhe bashkëpunimi i Policisë së Kosovës me misionin e Bashkimit Evropian për sundim të ligjit (EULEX) dhe misionin e NATO-s në Kosovë, KFOR-in, në "aksionin e përbashkët, për t'i zmbrapsur dhe asgjësuar sulmet terroriste të organizuara nga Serbia në veriun e vendit tonë".

Ndërsa para se të votohet kjo rezolutë, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka bërë thirrje nga Kuvendi për sanksionim dhe ndëshkim të Serbisë nga faktori ndërkombëtar për sulmin ndaj Policisë së Kosovës. "Nëse kalon e pandëshkuar, atëherë ajo (Serbia) do ta përsërisë krimin", ka thënë Kurti. Po ashtu, Kurti ka bërë thirrje që organizatat Mbrojtja Civile dhe Brigada Veriore të shpallen organizata terroriste nga shtetet partnere të Kosovës.

Qeveria e Kosovës i ka shpallur këto dy organizata terroriste më 29 qershor. Ato besohet se veprojnë në veriun e Kosovës dhe numërojnë qindra pjesëtarë nga radhët e komunitetit serb, që janë shumicë në këtë zonë. Më tutje, Kurti i ka falënderuar të gjitha shtetet që e kanë dënuar sulmin ndaj Policisë së Kosovës dhe për mbështetjen që kanë ofruar.

"Lufta kundër krimit e terrorit të sponsoruar nga Serbia vazhdon. Ajo do të përfundojë doemos me fitoren e shtetit tonë të pavarur", ka thënë Kurti.

Kurse shefja e grupit parlamentar e Lëvizjes Vetëvendosje, Mimoza Kusari-Lila, ka bërë thirrje për unitet politik, në këtë periudhë kur, sipas saj, është duke u sfiduar integriteti territorial i Kosovës. "E diela që lamë pas shpërfaqi një sulm të organizuar dhe të dirigjuar direkt nga Beogradi, për ta ndezur zjarrin e një konflikti të ri në Kosovë. Asnjë fakt nuk çon në ndonjë përfundim tjetër", ka thënë Kusari-Lila, duke fajësuar Serbinë për sulmin e 24 shtatorit. "Porosia dhe veprimi i të gjithëve duhet të jetë konsistent në dënimin e këtij terrori dhe këtij krimi... u kuptua se Serbia as nuk ka ndryshuar, as nuk e fsheh faktin që ka mbetur Serbia e (ish-liderit Sllobodan) Milloshevicit, vetëm se ndikimin e ka më të vogël dhe fushëveprimin më të ngushtuar", ka thënë ajo.

## Përmbajtja e rezolutës kundër sulmit terrorist në veri

- Duke e marrë për bazë gjendjen e sigurisë në të cilin po kalon vendi pas sulmit terroristë të Serbisë ndaj sovranitetit shtetëror dhe integritetit territorial të Republikës së Kosovës,

- Duke vlerësuar rëndësinë e ruajtjes dhe sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës së Kosovës si dhe përcaktimin dhe angazhimin tonë shtetëror për t'i kontribuar paqes dhe stabilitetit në rajon,

- Të vendosur që Republika e Kosovës të jetë vend i lirë, demokratik, paqedashës dhe atdhe i qytetarëve të saj të cilëve u garantohet të drejtat, liritë dhe barazia para ligjit,

- Të përkushtuar për ta luftuar dhe parandaluar me mjete kushtetuese dhe ligjore, çfarë do veprimi dhe përpjekje e cila e cenon, rrezikon rendin kushtetues të Republikës së Kosovës,

- Kuvendi i Republikës së Kosovës e dënon me termat më të ashpër sulmin terrorist të organizuar nga Republika e Serbisë mbi Policinë e Kosovës më 24 shtator 2023, si dhe kërkon nga faktori ndërkombëtar ta ushtrojë ndikimin e tij për ta ballafaquar Serbinë në rolin e saj në raport me organizimin dhe mbështetjen e çfarëdo llojshme që i ka bërë grupit terrorist për sulmin ndaj Republikës së Kosovës ,

- Vlerëson punën, angazhimin dhe rezultatet e jashtëzakonshme të institucioneve të sigurisë së Republikës së Kosovës dhe institucioneve partnere ndërkombëtare të sigurisë, EULEX dhe KFOR në aksionin e përbashkët për t'i zmbrapsur dhe asgjësuar sulmet terroriste të organizuara nga Serbia në veriun e vendit tonë,

- Ofron mbështetjen e plotë dhe pa rezervë për Policinë e Kosovës në ushtrimin e përgjegjësisë, ruajtjes së rendit dhe të sigurisë publike në tërë territorin e Republikës së Kosovës,

- Kërkon nga të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës që ta vazhdojnë punën e përbashkët për integrimin e plotë dhe bashkëjetesën mes gjitha komuniteteve pa dallim të cilat jetojnë në Republikën e Kosovës,

- Inkurajon dhe mbështetë pluralizmin politik në radhët e komunitetit serb në Kosovë, zhvillimi i të cilit e mundëson progresin demokratik dhe e rritë transparencën e llogaridhënien para këtij komuniteti dhe jetëson promovimin e interesave reale të tij në Republikën e Kosovës,

- Kërkon nga Qeveria e Kosovës që të bashkëpunon me aleatët ndërkombëtarë, veçanërisht me Shtetet e Bashkuara të Amerikës për ta fuqizuar edhe më tutje shtetin e së drejtës dhe vlerat tona të përbashkëta euro-atlantike,

- Konstaton nevojën për hetim ndërkombëtar ndaj Republikës së Serbisë lidhur me organizimin e aktiviteteve terroriste dhe vazhdimin e ekzistencës së kampeve stërvitore të grupeve terroriste në territorin e Serbisë.

### Opozita në një zë me pushtetin kundër sulmit në veri

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (LDK), Memli Krasniqi, ka bërë thirrje për hetim ndërkombëtar për ta vërtetuar përfshirjen e Serbisë në këtë sulm. "Mposhtja e grupit terrorist në Banjskë të Zveçanit nuk është përfundimi i qëllimeve dhe synimeve të Serbisë karshi Kosovës, e që është destabilizimi i skajshëm i vendit tonë. Për mua dhe PDK-në është krejtësisht e qartë se organizimi dhe orkestrimi i sulmit terrorist mbi republikanët tanë, adresën kryesore e ka në Beograd", ka thënë Krasniqi.

Ai ka theksuar se Kosova duhet të kërkojë "ekstradimin e terroristëve nga Serbia të cilët e kanë kryer sulmin ndaj mbi shtetin tonë". "PDK-ja është e përkushtuar që interesat e shtetit t'i vë mbi të gjitha. I bëj thirrje komunitetit ndërkombëtar që të nisë

→

# BE-ja godet Serbinë: Nuk mund të barazohen terroristët me viktimat e terrorizmit

**Bruksel, 28 shtator** - Bashkimi Evropian (BE) e ka kritikuar Serbinë lidhur me shpalljen e ditës së zisë për sulmuesit e vrarë në veri të Kosovës më 24 shtator.
Zëdhënësi i Bashkimit Evropian, Peter Stano, ka thënë për gazetarët se "nuk mund të barazohen viktimat e terrorizmit me terroristët". Ai ka thënë se në zyrat e BE-së në Prishtinë flamuri është ulur në gjysmështizë të hënën pasi në Kosovë ishte ditë zie për ta nderuar policin e vrarë të Kosovës, Afrim Bunjaku, por nuk ka vepruar kështu kur në Serbi u shpall ditë zie. "Kemi parë se Serbia dje ka shpallur ditë zie. Të hënën zyra e BE-së në Prishtinë vendosi flamurin në gjysmështizë për ta nderuar policin e vrarë dhe policët e plagosur, viktima të sulmit qyqar terrorist të dielën. Qëndrimi ynë është i qartë dhe ai është shprehur nga përfaqësuesi i lartë (Josep Borrell) më 24 shtator. Për më tepër, sulmuesit kurrë nuk mund të barazohen me viktimat. Prandaj, delegacioni i BE-së në Serbi nuk e ka vendosur flamurin në gjysmështizë. Në përgjithësi, BE-ja është fundamentalisht kundër madhërimit të kriminelëve dhe terroristëve dhe kundër mbajtjes së zisë për ta", ka thënë Stano.
Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka deklaruar se nuk mund t'i konsiderojë "kurrë terroristë" sulmuesit në Banjskë. Duke u përgjigjur në pyetjet për këtë deklaratë, Stano ka thënë se, sipas BE-së, sulmi ndaj Policisë së Kosovës më 24 shtator ishte sulm terrorist dhe, si i tillë, duhet të trajtohet dhe hetohet. "Para së gjithash më lejoni ta përsëris shumë qartë qëndrimin e Bashkimit Evropian për atë që ndodhi të dielën. Ai ishte një sulm terrorist dhe si sulm terrorist duhet të hetohet. Dhe ata që janë përgjegjës duhet të sillen para drejtësisë. Secili që ka rol duhet të bashkëpunojë në mënyrë që ky sulm terrorist jo vetëm të hetohet në tërësi, por të ketë përgjigje para drejtësisë për ata që e planifikuan, kryen dhe që qëndrojnë prapa këtij sulmi", ka thënë Stano. Ai ka thënë se BE-ja



"nuk lëshohet në komente për çdo deklaratë apo secilin interpretim", por theksoi se "duhet të ketë qartësi për atë që ndodhi të dielën".
Më herët BE-ja ka thënë se po pret përfundimin e hetimeve për të vendosur nëse do të ndërmarrë masa, teksa në bllok disa shtete kanë kërkuar që Serbia të ndëshkohet për rastin në Banjskë të Zveçanit.
Policia e Kosovës është sulmuar nga një grup i maskuar dhe i armatosur, teksa forcat e rendit po tentonin t'i largonin barrikadat që ishin vendosur në një rrugë në fshatin Banjskë të Zveçanit – një prej katër komunave në veri të banuara me shumicë serbe.
Grupi i armatosur, që sipas autoriteteve përbëhej prej rreth 30 personash dhe më pas është strehuar në manastirin e Banjskës, prej ku gjatë gjithë të dielës është përleshur me policinë.
Policia dhe ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, kanë thënë se udhëheqës dhe pjesëmarrës i këtij sulmi ishte Millan Radoiçiq, nënkryetar i Listës Serbe - partisë kryesore të serbëve në Kosovë që gëzon mbështetjen e Beogradit zyrtar.
Për pjesëmarrjen e Radoiçiqit, i cili është nën sanksione amerikane dhe kërkohet në Kosovë për frikësimin e dëshmitarëve në rastin gjyqësor të njohur si "Brezovica", Sveçla ka publikuar edhe një video të incizuar me dron, që tha se e shfaq zyrtarin e Listës Serbe në Banjskë.
Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka thënë se Radoiçiqi gjendet në Serbi dhe ai do të merret në pyetje nga organet serbe. Aktualisht katër persona janë të arrestuar për ngjarjet në Banjskë, teksa policia ka ekspozuar më 25 shtator armë dhe pajisje të tjera që ka thënë se janë konfiskuar në këtë fshat.
Kosova e ka bërë përgjegjëse Serbinë për sulmin, ndërsa Beogradi zyrtar serbët e Kosovës.

# Rama nuk tërhiqet: BE-ja duhet ta dënojë sulmin në Banjskë

**Tiranë, 28 shtator** - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, deklaroi se Brukseli është i zhgënjyer me Shqipërinë, e cila kërkon një deklaratë të re nga Bashkimi Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, por sërish nuk tërhiqet nga qëndrimi i saj. "Kemi kërkuar që deklarata që u publikua dje, të përfshinte edhe zhvillimet e fundit në Banjskë, ku u vra një punonjës policie nga një grup kriminal. Miqtë në Bruksel na kanë shpjeguar se nuk ishte e mundur diçka e tillë pasi deklarata që u publikua ishte konfirmuar nga blloku i vendeve anëtare. Na u kërkua linjëzimi, por përgjigjja jonë ishte negative", ka thënë Rama në një konferencë për media në enjten. Ai ka thënë se Shqipëria do të jetë gati të vihet në një linjë me një deklaratë të re të Bashkimit Evropian që duhet ta përfshijë dënimin për veprimet dhe mosveprimet e Serbisë.
Rama ka dalë para medieve për ta shprehur shqetësimin serioz si asnjëherë më parë në 10 vjet për rrezikshmërinë e lartë në veriun e



Kosovës. Kryeministri i Shqipërisë ka thënë se nuk e kupton se çfarë pret Bashkimi Evropian për të dalë me një deklaratë të tillë. "Zëdhënësi i BE-së tha dje se nuk do të ketë deklaratë tjetër pa u zbardhur hetimet se si ndodhi ngjarja në Banjskë. Edhe mund të ishim dakord nëse Serbia do të distancohej nga grupi kriminal e do të ishte deklaruar menjëherë hapjen e një hetimi serioz e të pavarur. Por, në vend të kësaj, Serbia zgjodhi nderimin për të vrarët", ka thënë Rama.
Ai ka thënë se ka rezervat e tij për liderët e Kosovës dhe qëndrimin e tyre sa i takon procesit të dialogut, por në këtë rast, Shqipëria është në krah të Kosovës. "Udhëheqja e Kosovës ka kusuret e veta në procesin e dialogut, por asnjë prej tyre nuk e relativizon peshën e këtyre zhvillimeve të rënda, që nuk krahasohen me asgjë të keqe të ndodhur prej fundit të luftës së vitit 1999. Jemi para derdhjes së gjakut të pafajshëm. Është gjaku i një efektivi të policisë së shtetit të Kosovës. U vra nga njerëz të veshur ushtarakisht e të armatosur rëndë, që për Beogradin janë të denjë për ta ulur në gjysmështizë flamurin. Ky është një karshillëk sa nga ana e grupit kriminal, ashtu edhe nga institucionet e Serbisë. Nuk ka nevojë për hetim, por kërkon dënim", ka thënë Rama.
Duke sjellë në vëmendje një deklaratë të mëhershme të tij, se nevojitet një konferencë ndërkombëtare për Kosovë, Rama tha se formati i dialogut duhet të ndryshojë menjëherë. "Formati i dialogut duhet ngritur në një nivel konference, ndërsa përfaqësimi i BE-së dhe i komunitetit euroatlantik duhet ngritur në nivelin më të lartë, me Francën dhe Gjermaninë në nivelin e presidentit dhe kancelarit. Formati i deritanishëm, ku takohen dy burra, nuk ka më asgjë për t'i ofruar paqes në këtë situatë të re. KFOR-i duhet të marrë nën kontroll veriun e Kosovës. Më vjen mirë që këtë tashmë e kërkon edhe Kosova, Ashtu siç më vjen mirë që Vjosa Osmani ka kërkuar pjesëmarrjen e ShBA-së për hartimin e një drafti për Asociacionin. Është një hap më në fund në drejtimin e duhur", është shprehur Rama.
Ai ka thënë se nëse kjo nuk ndodh, stokut të marrëveshjeve mund t'i shtohet edhe një stok viktimash. Rama ka thënë se një draft për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe duhet të jetë sipas Kushtetutës së Kosovës. Duke iu referuar edhe propozimit të tij për një draft-statut për Asociacionin, Rama ka thënë se nuk ka rëndësi kush e shkruan, por çfarë sjell për dy vendet.
Kryeministri Rama ka thënë se Kosova, sot, më shumë sesa para se të ndodhte tragjedia, duhet ta kërkojë dialogun dhe t'i besojë atij. Plani franko-gjerman, sipas Ramës, është ende në tryezë, andaj Prishtina duhet të reflektojë.

→

hetim për ta vërtetuar përfshirjen e shtetit serb", ka thënë Krasniqi.
Ndërsa kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka thënë se synimi i sulmit të 24 shtatorit ka qenë krijimi i një realiteti të ri në veri. Sipas tij, përgjigjja e autoriteteve të Kosovës ndaj sulmit ka qenë "më adekuatja e mundshme". "Faktet janë të qarta. Kosova nuk e ka sulmuar Serbinë. Kosova nuk e ka vrarë një polic të shtetit tjetër. Nga Kosova nuk janë nisur mjete e trupa ushtarake drejt një shteti tjetër. Në Kosovë nuk janë kthyer individë të armatosur pasi e kanë vrarë një polic të shtetit tjetër. Kosova nuk ka vendosur trupa të armatosura në objekte fetare", ka thënë Abdixhiku, duke shtuar se tani është koha që Kosova të tregohet e suksesshme edhe në diplomaci. "LDK-ja me të gjitha kapacitetet e saj do t'i mbështesë gjithherë institucionet e Kosovës në përballje të tilla. Sot na duhet mençuri. Atë që fituam në Banjskë, duhet ta fitojmë në politikë dhe diplomaci. Është përgjegjësi e qeverisë, që këtë situatë ta kthejë në avancim të pozicionit tonë ndërkombëtar", ka thënë Abdixhiku.
Në anën tjetër, kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se një rezolutë që e dënon sulmin në Banjskë është e drejtë dhe Kuvendi i Kosovës duhet ta aprovojë. "Në këtë rezolutë kërkoj që të përfshihet kërkesa për hetim ndërkombëtar. Ky hetim do të ndihmonte jo vetëm për zbardhjen e përfshirjes së Serbisë në këtë sulm terrorist ndaj Kosovës, por do ta ndihmonte bashkësinë ndërkombëtare që t'i ndëshkojë sponsorët e terrorizmit", ka thënë ai.
Haradinaj e ka kritikuar kryeministrin Albin Kurti në lidhje me dialogun dhe anashkalimin që ia bën ShBA-së në favor të BE-së. "Ju kam kërkuar mbështetuni, bazohuni tek Uashingtoni për marrëveshje, merruni vesh me Uashingtonin për marrëveshjen për Serbinë për njohje. Kurti, pra kryeministri ynë, e ka zgjedhur të kundërtën. Ka zgjedhur Borrellin dhe Lajçakun. I ka ikur Uashingtonit, i ka prishur marrëdhëniet dhe besimin me t`. Pyeteni veten pak nëse kish ndodh kështu, nëse do të kishte vepruar në kohë ashtu. Tani Kurti fajëson Borrellin dhe Lajçakun që vetë i ka zgjedh. Nuk e ka zgjedh Uashingtonin, por ka zgjedhur Borrellin dhe Lajçakun dhe i fajëson ata. Ju lutem, mashtrimi nuk kalon. Jemi mashtruar që dy vjet. Jemi mashtruar në Kosovë nga mashtruesi", ka thënë Haradinaj.
Krejt në fund shefi i grupit parlamentar multietnik, Enis Kervan, ka thënë se vdekja e rreshterit Bunjaku shërben si përkujtim për sfidat me të cilat përballet Kosova në pjesën veriore të vendit.
Sulmet ndaj Policisë së Kosovës janë dënuar nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian dhe është bërë thirrje për përballjen e fajtorëve me drejtësi.

## Vitia: Ligji i Pagave s'i ka adresuar më së miri problemet e punëtorëve

PRISHTINË, 28 SHTATOR - Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS), në bashkëpunim me Federatën e Sindikatave të Shëndetësisë të Kosovës (FSShK), ka mbajtur tryezë të rrumbullakët në lidhje me Ligjin e Pagave.
Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, i cili ka qenë i pranishëm në këtë tryezë, ka thënë se Ligji i Pagave nuk i ka adresuar të gjitha problemet e punëtorëve në mënyrën më të mirë. Vitia ka thënë se disa nga kërkesat e Federatës të Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës nuk janë të realizueshme.
"A i ka adresuar të gjitha problemet në mënyrën më të mirë? Nuk i ka adresuar, sidomos pjesën e infermierëve, por ne jemi në kontakt çdo javë për këto probleme dhe këto telashe. Me federatën deri tani kemi pasur shumë takime, mirëpo nuk janë shumë sa ka nevojë. Kërkesat e federatës janë ato që janë dhe ne u kemi treguar që për disa kërkesa, përkundër faktit që i mirëkuptojmë, për momentin nuk janë të realizueshme", ka thënë Vitia.
Sipas tij, stafi i mjekëve dhe ai i specialistëve kanë përfituar nga ky ligj. Vitia ka shtuar se mjekët dhe specialistët kanë




pagën më të lartë në rajon.
Ndërsa kryetarja e FSShK-së, Tevide Imeri, ka thënë se Ligji i Pagave ka bërë diskriminime dhe ka shkaktuar pakënaqësi te punëtorët. Imeri ka thënë se zbritja e pagave nuk duhet të zbatohet.

# Integriteti politik në Kosovë, lënë për të dëshiruar regjistri i zyrtarëve publikë dhe mënyrat e votimit të deputetëve

PRISHTINË, 28 SHTATOR - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka bërë një hulumtim rreth integritet politik në Kosovë.
Ky hulumtim që është realizuar duke përdorur metodologjinë e Transparency International bazohet në tregues si regjistrat e zyrtarëve publikë, deklaratat e pasurisë së tyre, raportet financiare të partive politike, buxheti dhe shpenzimet e qeverisë, prokurimi publik, transkriptimet e votave të deputetëve të Kuvendit dhe regjistrat e bizneseve. "Në vitin 2018 Ministria e Financave lansoi portalin e transparencës me fokus buxhetin dhe shpenzimet e qeverisë. Fatkeqësisht, kjo platformë ka mbetur në harresë që nga viti 2021, duke e bërë atë të papërdorshme si një burim aktual. Tutje, vlerësimi zbulon ekzistencën e burimeve të të dhënave të qasshme dhe pa kosto nga publiku në lidhje me buxhetin publik (në formën e dokumenteve ligjore duke përfshirë tabelat) dhe shpenzimet e qeverisë (raportet financiare). Megjithatë, këto burime të dhënash janë ekskluzivisht të disponueshme në formatin PDF", ka njoftuar IKD-ja.
Më tutje, KDI-ja ka theksuar se së fundi Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka iniciuar publikimin e raporteve financiare të partive politike në faqen zyrtare. "Megjithatë, këto burime të dhënash paraqiten në formën e imazheve të skanuara, duke i bërë ato mjaft sfiduese për t'u ripërdorur ose analizuar në mënyrë efektive. Dy aktivitetet me performancë më pak të




kënaqshme janë ato për regjistrin e zyrtarëve publikë dhe mënyrës së votimit të deputetëve. Sidoqoftë, dy aktivitetet publike që shfaqin performancën më pak të kënaqshme janë ato që lidhen me regjistrin e zyrtarëve publikë dhe të dhënat për mënyrën si kanë votuar deputetët e Kuvendit të Kosovës. Publikimi më i fundit i regjistrit të zyrtarëve publikë daton në vitin 2018. Gjithashtu, që nga viti 2019 pajisjet elektronike të votimit brenda institucionit të Kuvendit kanë qenë jofunksionale, duke pamundësuar kështu nxjerrjen e të dhënave për mënyrën e votimit individual të secilit deputet gjatë tre viteve të fundit", ka njoftuar KDI-ja.
Sipas KDI-së, kjo analizë rendit prokurimin publik si aktivitetin publik me disponueshmërinë më të lartë të të dhënave në format të hapur me 10.5 pikë, deklarimi i pasurisë, regjistri i bizneseve dhe raportet e shpenzimeve të qeverisë me nga 8.5 pikë secila, pasuar nga raportet financiare të partive politike me 8 pikë, buxheti i Kosovës me 7.5 pikë, regjistrin e zyrtarëve publikë me 1 pikë dhe 0 pikë për disponueshmërinë e transkriptimit të votimeve të deputetëve të Kuvendit të Kosovës.

# Aktakuzë ndaj dhjetë personave për import dhe eksport të armëve, kultivim të narkotikëve dhe falsifikim dokumentesh

PEJË, 28 SHTATOR - Prokuroria Themelore në Pejë ka ngritur aktakuzë ndaj dhjetë personave (H. S., R. Gj., M. H., K. L., F. L., M. N., S. J., H. J., S. B. dhe Sh. J.) për veprat penale "Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse", "Kultivimi i bimës së hashashit, shkurres së kokainës ose bimëve të kanabisit" , "Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge", "Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve" dhe "Falsifikimi i dokumenteve", të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.
Sipas aktakuzë, të pandehurit H. S., R. Gj., M. H., K. L. dhe F. L., në bashkëveprim gjerë më 7 shtator 2022, në regjionin e Pejës kanë blerë,




furnizuar, ndërmjetësuar dhe kanë shitur armë e municion të llojeve të ndryshme mes vete dhe personave të tjerë, ku në vazhdimësi kanë kryer veprën penale "Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse", nga neni 364, paragrafi 1, lidhur me nenin 31 dhe 77 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.
Të pandehurit M. N., S. J., H. J. dhe S. B., sipas aktakuzës së ngritur nga prokurori i shtetit, në fshatin Drejë të komunës së Istogut, në bashkëveprim, pa autorizim, kanë kultivuar bimën e kanabisit me qëllim të prodhimit të narkotikëve ose substancave psikotrope dhe atë të llojit "marijuanë". Në fshatin e lartshënuar ata kanë kultivuar 92 (nëntëdhjetë e dy) copë bimë narkotike të llojit "kanabis sativa" në lartësi prej 200cm, ku me këto veprime kanë kryer veprën penale "Kultivimi i bimës së hashashit, shkurres së kokainës ose bimëve të kanabisit", nga neni 272, paragrafi 1, lidhur me nenin 31 të KPRK-së.
I pandehuri M. N. është duke u akuzuar se gjatë kontrollit në shtëpinë e tij janë gjetur nga Policia e Kosovës 42.65 gramë narkotikë të llojit "kokaina", me ç'rast ka kryer veprën penale "Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge", nga neni 269, paragrafi 1 i KPRK-së. Po ashtu, i pandehuri M. N. është duke u akuzuar edhe për veprën penale "Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve", nga neni 366, paragrafi 1 i KPRK-së.
Ndërsa i pandehuri Sh. J., sipas aktakuzës, gjatë kontrollit në shtëpinë e tij, Policia e Kosovës tek i pandehuri kishte gjetur në patentëshofer të falsifikuar të shtetësisë finlandeze, me ç'rast është duke u akuzuar për veprën penale "Falsifikimi i dokumentit" nga neni 390, paragrafi 1 i KPRK-së.
Me këto veprime ekziston dyshimi i bazuar mirë se të pandehurit kanë përmbushur elementet e veprave penale të përshkruara si më lart.
Prokurori i çështjes me rastin e ngritjes së aktakuzës i ka propozuar gjykatës që të pandehurit të shpallen fajtorë dhe të dënohen sipas ligjit për veprat penale të cilat u vihen në barrë.

## KRU 'Prishtina' shkyç konsumatorët borxhlinj në rrugën 'Muharrem Fejza'

PRISHTINË, 28 SHTATOR - Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Prishtina" ka njoftuar se ka bërë shkyçjen nga shërbimet e ujit për konsumatorët me borxhe në rrugën "Muharrem Fejza" në kryeqytet. Po ashtu, KRU-ja ka paralajmëruar edhe shkyçje të tjera. "Sapo u shkyçën konsumatorë në rrugën 'Muharrem Fejza' për borxhe të mëdha ndaj shërbimeve të ujit. Shkyçjet po aplikohen duke i përfillur dhe bazuar në rregulloret dhe ligjet në fuqi. Vazhdojmë tutje", ka njoftuar KRU "Prishtina".



# Pas ngjarjeve në veri, a mund të imponohet një marrëveshje e panegociueshme politike?!



Shkruan: Behxhet Sh. SHALA – BAJGORA

**Terrorizëm i maskuar si revoltë qytetare:** Në mëngjesin e së dielës që shkoi, struktura të organizuara kriminale serbe e që për bazë operative e kishin manastirin në Banjskë të Zveçanit, e provokuan situatën duke vendosur barrikada dhe kur policët e Kosovës shkuan për ta zhbllokuar rrugën, po këto struktura sulmuan me armë zjarri të kalibrave të ndryshëm, duke e vrarë rreshterin Afrim Bunjaku dhe plagosur dy policë të tjerë. Situata eskaloi pastaj duke vrarë, sipas informatave të verifikuara, tre serbë të uniformuar dhe të armatosur, kurse numri i të plagosurve nuk ishte i ditur për publikun as ditën kur ndodhi sulmi i armatosur e as sot. U arrestuan gjashtë sulmues të sulmit kriminal prej të cilëve katër u liruan dhe dy mbetën në paraburgim. Një numër i pacaktuar i sulmuesve, në mesin e të cilëve ishte edhe Radojiçiqi, zëvendëskryetar i Listës Serbe, u larguan përmes një korridori sigurie që ua mundësuan forcat ndërkombëtare pas negociatave me Qeverinë e Serbisë. Qeveria e Kosovës në këtë rast vetëm ka mundur të garantojë dhe sigurisht edhe ka garantuar se nuk do t'i vrasë sulmuesit që u larguan nga vendi i krimit duke ecur sikur në një promenadë vere e jo se ishin në siklet për jetën e tyre. Mbështetur në fotot që dukeshin, të gjithë ata që ecnin me armatim në duar dhe në krahë, lehtësisht do të eliminoheshin nga një ekip snajperësh në një afat shumë të shkurtër. Në këto situata kur mungojnë faktet apo kur ato më shihen ose shtrembërohen dolën njëmijë e njëqind tregime, analiza dhe përralla se si ndodhi, pse ndodhi, kush ishte prapa këtij grupi terrorist dhe se cili ishte qëllimi i këtij grupi. Thuhej se kishin për qëllim shpalljen e pavarësisë për veriun e Kosovës dhe ndarjen e saj e që unë nuk besoj për faktin se Serbia nuk është e interesuar ta marrë veriun, por është jetësisht e interesuar të mbajë, kontrollojë dhe forcojë të gjitha lokacionet në Kosovë ku jetojnë serbët në mënyrë që ta mbajë Kosovën gjithmonë nën kërcënim të destabilizimit. Kësaj radhe e ka aktivizuar vetëm veriun, kurse serbët që jetojnë poshtë lumit Ibër i ka udhëzuar të qëndrojnë të qetë deri në çastin kur do të kenë interesim për aktivizimin e tyre.

U ekspozuan shumë armë në mesin e të cilëve kishte armë që i përdorë ushtria dhe njësitet speciale kundër mjeteve të blinduara dhe kundërajrore, që nënkupton se kishin paraparë sulme edhe ndaj këtyre caqeve. Dolën fjalë se është plagosur rëndë edhe vet Radojiçiqi dhe se gjendet në trajtim në Akademinë Mjekësore Ushtarake (VMA) në Beograd. U kërkua që të ndërpritet apo kushtëzohet dialogu me dorëzimin e grupit terrorist që po strehohet në Serbi në kohën kur Serbia nuk ia dorëzon Kosovës as një të arrestuar për vjedhje të pulave e lëre më t'i dorëzojë personat që vet i ka ushtruar, i ka pajisur me armatim dhe logjistikë për ta destabilizuar Kosovën duke ushtruar dhunë dhe terror që nga përfundimi i luftës e deri më sot. Se kush qëndron prapa krejt këtij grupi, nuk duhet të jeni aspak i mençur e ta qëlloni.

Serbia ishte prapa, me gjithë infrastrukturën politike, ushtarake, policore dhe kishtare. Ishte BIA-ja dhe Vulini që vepronin sipas telekomandës së Vuçiqit.

Po pse rrodhën gjërat si rrodhën: nuk ka asnjë dyshim se strukturat zbuluese dhe kundërzbuluese ndërkombëtare në Kosovë dhe jo vetëm në Kosovë kishin informata të plota dhe të sakta mbase nga vet burimet serbe për tërë këtë grup, armatimin dhe dinamikën e zhvillimit të ngjarjeve dhe se një pjesë të këtyre informatave ( sigurisht jo të gjitha ) i ndanë me strukturat simotra të Kosovës, aq sa i duheshin institucioneve përgjegjëse të Kosovës të marrin veprimet e duhura dhe të domosdoshme.

**Çka mund të pritet nga kërkesat:** Njëra ndër kërkesat kryesore ishte që Lista Serbe të shpallet parti terroriste dhe të ndalohet me ligj aktiviteti i saj që midis rreshtave e paralajmëroi edhe Vojsa Osmani, presidente e Kosovës. Punë kjo që nuk bëhet për faktin se asnjë ligj në Kosovë e as në botë nuk e zbaton parimin e përgjegjësisë kolektive por se përgjegjësia është individuale. Mund të kallëzohen penalisht udhëheqësit e Listës Serbe (nëse sigurohen prova të besueshme) dhe të ndiqen individualisht, asgjë më tepër. Lista Serbe është parti parlamentare në Kosovë me 10 deputetë dhe çdo përpjekje për ndëshkim në bazë të përgjegjësisë kolektive, qoftë vetë edhe si propozim vetëm sa do ta forcojë këtë parti. Përgjegjësia penale është individuale. Jam i sigurt se lirimi i të ndaluarve për katër sulmuesit e armatosur është në funksion të depërshkallëzimit të situatës sikur edhe korridori i sigurisë që mundësoi largimin e anëtarëve tjerë të grupit terrorist, në me krye Radojiqiqin është në të njëjtin funksion. Gjithashtu jam i sigurt se institucionet e Kosovës nuk janë pyetur shumë për këto zhvillime dhe se bisedimet janë zhvilluar në relacionin ndërkombëtarë - Serbi.

Pasi përfunduan veprimet policore, si gjithkund në botë, politikanët vendosën kurorën e dafinës në kokën e tyre, si fitues, duke lëshuar deklarata që i përshtaten, jo një gjykimi të arsyeshëm por një shpërthimi euforik, si nevojë e domosdoshme për përmbushjen e kompleksit të inferioritetit apo forcimin e ndjenjës së madhështisë të cilën, as nuk e kishin, as nuk e kanë e as nuk do ta kenë në të ardhmen. Politikanët e Kosovës ishin më të përmbajtur se ata të Serbisë, në emër të tyre flisnin ndërkombëtarët duke ua peshuar dhe duke ua ditur sedrën. Por një gjë është shumë e sigurt; sot askush nuk të përkrahë pa fituar diçka që ata e duan. Sigurisht se faturat me kërkesa politike do dërgohen më vonë në adresë të Kosovës. Policët e Kosovës nuk folën shumë, madje fare pak por vepruan në mënyrë profesionale, madje shumë profesionale ndonëse thuaja në të gjitha vendet policët dhe ushtarët nga politikanët konsiderohen vetëm si numra dhe si mundësi për të marrë pushtetin apo për ta mbajtur atë. Bisedimet sikur edhe formati i tyre jo që nuk do të ndryshojë e lëre më të ndërpriten por do të dinamizohen. Realisht, këto zhvillime me përfundime tragjike edhe përdoren nga vendimmarrësit e vërtetë për të kushtëzuar politikisht palët në bisedime duke iu ofruar propozime të panegociueshme sikur që ishte psh. konferenca në Rambuje, sidomos për palën më të dobët. Në çaste të ereksionit euforik u propozua të refuzohen të gjitha marrëveshjet me Serbinë, të kushtëzohen bisedimet me njohje nga Serbia, me njohje nga pesë vendet mosnjohëse, t'i futen sanksionet Serbisë etj. sikur që Kosova të ishte i vetmi vend në botë që zotëron armët bërthamore. Presidentja Vojsa Osmani, të gjitha përpjekjet po i bënë për t'ia pakësuar barrën kryeministrit Kurti, për t'ia lehtësuar sado pak pozitën prandaj thirri subjektet opozitare politike duke e pasur të qartë se në këtë gjendje asnjë subjekt nuk do ta refuzojë këtë ftesë. Ftesë e tipit folklorik sikur që ishin folklor politik edhe deklaratat e pjesëmarrësve në këtë takim.

Deklaratë stereotipe që nuk del jashtë kornizës folklorike, mbi patriotizmin dhe atdhedashurinë! Albin Kurti dhe Vojsa Osmani janë sjellë në mënyrë më shpërfillëse dhe më jonjerëzore ndaj opozitës e sidomos ndaj PDK-së nga urrejtja patologjike që e kanë ndaj Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit. As nuk janë konsultuar me opozitën për asnjë veprim e as për këto ngjarje, por se duan që me opozitën t'i ndajnë pasojat. Asgjë më shumë. Se duan të blejnë kohë dhe të sigurt se nuk ka mundësi të devijojnë nga detyrimet e trashëguara dhe pasojat katastrofale të marrëveshjes së Brukelit, plus aneksi i Ohrit.

Vojsa Osmani shfaqë disa rezerva të qullëta për këtë dhe propozon që draftin për Zajebnicën ta bëjnë bashkë me amerikanët në ndërkohë që amerikanët kërkojnë të zbatohen pa vonesë dhe pa ndryshime marrëveshjet e arritura. Ec dhe gjendu në këtë situatë!

**Kush humb e kush fiton:** Aleksandar Vuçiqi artin e gënjeshtrës, mashtrimit, manipulimit dhe vajit e ka ngritur në nivel të artit, artit të së mundshmes. Deri më tani po i dhezë, sidomos të ndërkombëtarët, mos të flasim për serbët. Në Serbi nuk ka opozitë, gjenerali Ponosh dhe Gjillasi me asgjë nuk mund ta rrezikojnë përveç me një fjalor më të radikalizuar sa i përket Kosovës. Ndërkombëtarët e kanë të qartë se Vuçiqi në çdo kohë mund ta destabilizojë Bosnjën dhe Hercegovinën (faktikisht e ka ndarë), Malin e Zi, Kosovën madje nëse ka interes mund ta dridh edhe Maqedoninë e Veriut. Serbia doli haptas në anën e Rusisë në luftë kundër Ukrainës dhe nuk e pati asnjë sanksion.

Serbia është shumë e afërt me Kinën, shumicën e vendeve islamike (ish-vendet e painkuadruara), me Indinë, Kinës, Iranin, Brazilin dhe Argjentinën. Francën e ka shumë afër historikisht dhe politikisht, Anglia ka interesa të mëdha ekonomike sidomos në veri të Kosovës (minierat dhe Liqeni i Ujmanit), në kohën e kancelares Merkel ka qenë e "përkëdhelura e Ballkanit". Sipas logjikës se ekspertëve të sigurisë, kush ka kapacitet për të destabilizuar, ka kapacitet edhe për të stabilizuar, sidomos në Ballkanin e trazuar. Me këto zhvillime Vuçiqit i është dhënë një mundësi e artë të lirohet nga Radojiçiqi dhe nga Vulini për të mbetur i palagur dhe i pranuar nga ndërkombëtarët. Vuçiqit nuk i intereson marrëveshja me Kosovës ku Kosova do të jetë shtet i pavarur dhe sovran. Atij i intereson që ta kthejë apo ta ketë një kontroll në Kosovë dhe mbi Kosovën përmes kërcënimit për destabilizim të përhershëm duke i shfrytëzuar serbët lokalë.

Marrëveshja e Brukselit dhe aneksi i Ohrit e hapë një mundësi të tillë për Serbinë. Fillimisht në mënyrë diskrete. Në fund të fundit në përpjekje për ta bishtnuar marrëveshjen, Vuçiqi i shpallë zgjedhjet e jashtëzakonshme sikur që edhe e paralajmëroi mbrëmë në një intervistë në Radio Televizionin e Serbisë ku si magjistar i mashtrimit shpërndau shumë rrena dhe të pavërteta. Vuçiqi është i vetëdijshëm se nuk e ka asnjë konkurrent në "botën serbe" dhe se është lojtar i pazëvendësueshëm në procesin e bisedimeve për ndërkombëtarët. Nuk mund ta rrezikojnë seriozisht madje as Nenad Rashiqi e Rada Trajkoviq. Aleksandar Vuçiqi do ta luajë deri në fund lojën "tërhiqe dhe mos e këput", nuk do të refuzojë bisedimet por nuk do të pranojë marrëveshje ku Kosova do të detyrohet të pranohet e pavarur nga ai apo Serbia. Pse në rastin konkret Vuçiqi është zënë cullak, nuk e ka aspak problem, nuk është hera e parë e as e fundit. Përmes intervistave ka filluar t'i riciklojë rrenat dhe mashtrimet, i bindur në pozitën që e ka në procesin negociues dhe në ruajtjen e stabilitetit të Ballkanit. Një proverb kinez thotë se: "kur të poshtrin dhe të pafytyrin e pështyni në surrat, ai thotë se po bie shi...". I tillë është Vuçiqi!

Albin Kurti po del të jetë fitues i çastit. Të gjithë po e thonë këtë. Nga një izolim ndërkombëtar menjëherë po e thërrasin me telefon, Çollet dhe të tjerët. Jo për ta pyetur për shëndetin, por për t'i rikujtuar për zotimet e paplotësuara. Albin Kurtit i rri mbi kokë Zajbnica, Marrëveshja e Brukselit dhe aneksi i Ohrit. Albini e ka të qartë se nuk janë të mira, aspak të mira, por se nuk ka hapësirë manovrimi. Përmbushjen e këtyre zotimeve mund ta shtyjë vetëm nëse shkon në zgjedhje të reja apo nëse Vuçiqi e rrëzon Qeverinë e Serbisë duke shkuar në zgjedhje të jashtëzakonshme. As Albini e as Vuçiqi nuk duan marrëveshje, kjo pikë i bashkon. Vuçiqi mbetet përsëri lojtar i pazëvendësueshëm edhe nëse Serbia shkon në zgjedhje. Albin Kurti, pas zgjedhjeve eventuale të jashtëzakonshme, pavarësisht se do të dalë fitues më nuk do të jetë në krye të qeverisë, nuk do ta ketë një mundësi të tretë nga ndërkombëtarët. Presioni kryesorë do të shkojë te Albini nga i cili do të kërkohet të bëjë lëshime në emër të partneritetit me "miq ndërkombëtarë". Në emër të ndihmës dhe bashkëpunimit me ndërkombëtarët siç ishte rasti i Manastirit të Banjskës. Albin Kurtit do t'i marrin ajrin rreth hapësirës së veprimit dhe mbijetesës politike dhe jo vetëm politike. Mos qofsha në lëkurën e tij! Se nuk do të ndahemi mirë, nuk e kam asnjë dyshim. Kosovës i duhet një lider dhe një politikë që këto humbje t'i bëjë sa më të vogla, sa më të durueshme dhe sa më pak të dhimbshme. A do të jetë ky Albin Kurti, nuk e di! Kemi shpërputhje të mëdha midis mundësive dhe dëshirave. Të pakapërcyeshme. Albin Kurti duhet të dalë para popullit dhe t'i tregojë realitetin e trashëguar dhe të krijuar nga vetë ai. Kjo është e vetmja gjë që kërkohet nga ai tani! A do ta bëjë, nuk e di. Duhet ta bëjë! Nuk ka mundësi tjetër!

## Ekonomia gjermane këtë vit pritet të tkurret 0.6 për qind




**Berlin, 28 shtator** - Pesë institute ekonomike kanë parashikuar se Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) në Gjermani do të tkurret 0.6 për qind në vitin 2023, ndërsa rritja pritet të jetë 0.3 për qind.
"Arsyeja më e rëndësishme për këtë rishikim është se industria dhe konsumi privat po shërohen më ngadalë sesa prisnim në pranverë", ka thënë kreu i Departamentit të Makroekonomisë në Institutin Halle për Kërkime Ekonomike (IWH), Oliver Holtemoeller.
Ndjenja e të bërit biznes është përkeqësuar kohën e fundit dhe treguesit sugjerojnë që PBB-ja ka rënë dukshëm në tremujorin e tretë të vitit 2023.
PBB-ja pritet të zvogëlohet 0.4 për qind në tremujorin e tretë, pas ngecjes në tremujorin e dytë.
Sidoqoftë, rritjet e pagave ka ndjekur rritjet e çmimeve. Në tremujorin e fundit të 2023-s, rritja parashikohet 0.2 për qind.

# Kosova merr 20 milionë dollarë kredi për digjitalizim



**Prishtinë, 28 shtator** - Kosova ka nënshkruar Projektin për Qeverisje Digjitale, i cili synon përmirësimin e cilësisë së shërbimeve administrative publike të përzgjedhura dhe të qasjes së përdoruesve në to. Mbështetja e aprovuar financiare për projektin pesëvjeçar është kredi koncesionare prej 20 milionë dollarësh nga Asociacioni Ndërkombëtar për Zhvillim (IDA) i grupit të Bankës Botërore.
Kredia ka maturitet prej 25 vjetësh dhe grejsperiudhë prej pesë vjetësh. Projekti do të zbatohet nga Agjencia për Shoqërinë e Informacionit, ndërsa do të fokusohet në tri komponentë, në transformimin digjital të qeverisë, atë për shërbime publike, si dhe ngritjen e kapaciteteve.
Lajmin e ka bërë me dije ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, pas nënshkrimit të projektit me menaxherin e Bankës Botërore për Kosovën dhe Maqedoninë e Veriut, Massimiliano Paolucci. "Projekti ka tre komponentë: transformimin digjital të qeverisë, transformimin digjital për shërbime publike dhe ngritjen e kapaciteteve. Te transformimi digjital i qeverisë, një shembull i kësaj do të ishte nënshkrimi digjital, i cili na është kërkuar nga Banka Botërore. Transformimi digjital për shërbime publike, shumë certifikata dhe dokumente mund të shkarkohen online, pa pasur nevojë për të pritur në sportele, por do të investohet edhe më shumë në këtë aspekt. Ngritja e kapaciteteve në mënyrë të qëndrueshme, që edhe pasi të përfundojë projekti, të kemi staf dhe sisteme të qëndrueshme", ka thënë Murati, duke dhënë detaje të kësaj kredie. "Ky projekt që financohet nga Banka Botërore është kredi koncesionare prej 20 milionë dollarësh nga Asociacioni Ndërkombëtar për Zhvillim (IDA) i grupit të Bankës Botërore. Kredia ka maturitet prej 25 vjetësh dhe grejs-periudhë prej 5 vjetësh me normë interesi 1.25 për qind që është një normë e mirë. Projekti do të zbatohet nga Agjencia për Shoqërinë e Informacionit", ka thënë Murati.
Ndërsa menaxheri i Bankës Botërore për Kosovë dhe Maqedoni të Veriut, Massimiliano Paolucci, ka thënë se Kosova ka arritur disa pika historike në drejtim të reformave digjitale, duke përfshirë një nga nivelet më të larta të lidhshmërisë në Evropë. Në këtë kontekst, ai ka thënë se përparimet nuk janë përkthyer mjaftueshëm në ofrimin e përmirësuar të shërbimeve për qytetarët dhe bizneset. Ai ka thënë se Kosova është vendi i vetëm në Evropë që ka internet të shtrirë në 100 për qind të territorit. "Zhvillimi i arkitekturës institucionale të qeverisjes digjitale dhe forcimi i infrastrukturës së rrjetit qeveritar dhe platformave të përbashkëta janë themelet kyçe për ta mbështetur transformimin digjital të shërbimeve qeveritare dhe publike. Digjitalizimi i suksesshëm i shërbimeve dhe nxitja e përdorimit të tyre do t'i përforcojë përpjekjet e Kosovës për luftimin e korrupsionit, për përmirësimin e fuqizimit të grave, si dhe për luftimin e ndryshimeve klimatike", ka thënë ai. Paolucci ka thënë se projekti, duke përmirësuar infrastrukturën digjitale, do ta përmirësojë edhe jetën e qytetarëve. "Ky projekt do ta përmirësojë infrastrukturën digjitale, njëkohësisht edhe jetën e qytetarëve. Kosova ka shënuar disa të arritura për transformimin digjital. Është vendi i vetëm në Evropë që ka mbërritur ta shtrijë internetin në të gjithë territorin", ka thënë ai.

# Parandalohet një rast i kontrabandës së mallrave




**Prishtinë, 28 shtator** - Policia e Kosovës ka identifikuar një kombi pa targa në kufirin me Maqedoninë e Veriut, me ç'rast, gjatë kontrollimit të mjetit, janë gjetur dhe sekuestruar mallra të dyshuara për kontrabandim, pa dokumente përkatëse.
Policia ka njoftuar se ky operacion është ndërmarrë për ta parandaluar kriminalitetin dhe dukuri të tjera negative. "Policia e Kosovës, respektivisht njësitë e task-forcës, në kuadër të policisë kufitare-lindje, me qëllim të luftimit dhe parandalimit të kriminalitetit dhe dukurive të tjera negative, kanë intensifikuar angazhimet operative dhe ushtrimin e autorizimeve policore në terren, ku si rezultat është identifikuar një mjet i dyshuar/kombi pa targa, i cili është zënë në flagrancë duke hyrë ilegalisht nga Republika e Maqedonisë së Veriut në Republikën e Kosovës. Pas ndalimit të mjetit të dyshuar nga ana e zyrtarëve policorë është legjitimuar drejtuesi i mjetit, i dyshuari mashkull kosovar, tek i cili gjatë kontrollimit të mjetit janë gjetur dhe janë sekuestruar mallrat e dyshuara për kontrabandim, pa dokumente përkatëse", ka njoftuar policia.
Më tutje, policia ka njoftuar se malli i ndalur është si në vijim: 99 pako me nga 12 kg mjaltë, 1 188 copë kavanoza qelqi, 100 pako me çajra për dobësim "Nerox", 200 pako me çajra "Detoxs", 300 copa sprej "Viga 150000", 100 kuti x12 copë "Exellent Q7", 200 copa "Titan Gel".
"Andaj, me vendim të prokurorit kompetent, rasti është iniciuar si 'kontrabandim me mallra' dhe është dërguar në terminal doganor", ka njoftuar policia.

## Rafuna dhe Szunyogu bisedojnë për klimën e të bërit biznes në Kosovë




**Prishtinë, 28 shtator** - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Lulzim Rafuna, ka pritur në takim Shefin e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Tomasz Szunyog, me të cilin ka biseduar për klimën e biznesit në vendin tonë.
Szunyogu ka bërë me dije se në takimin me Rafunën ka theksuar rëndësinë e tregtisë së lirë me vendet fqinje. "Takova kryetarin e Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, për të diskutuar mbi klimën e biznesit në Kosovë, potencialin e rritjes dhe mbështetjen e BE-së", ka potencuar Szunyog.
Ndërsa kryetari i OEK-ut, Lulzim Rafuna, ka shprehur mirënjohje dhe falënderim për përkrahjen e deritanishme nga Zyra e BE-së. Ai është shprehur i gatshëm për realizimin e projekteve të reja të përbashkëta.

ANALIZË NGA HISEN BERISHA

# Pasveprimi i një skenari të ndalur, por i papërfunduar!

## - Vazhdoje dialogun, stabilizoje situatën e mos e përdorë policinë - mesazhi i familjes së policit të vrarë



### *Policia veproi sipas vlerësimit të situatës

Ajo që meriton të bëhet është të përshëndeten veprimet e policisë për ruajtjen e integritetit dhe sovranitetit në vend, neutralizimi i pjesshëm dhe eliminimi i disa objektivave që paraqiten rreziqe aktive si dhe përzënia nga territori i grupit të armatosur serb që bëri invazion në territorin e Kosovës, synimi i të cilëve ishte kryerja e akteve terroriste ndaj rendit kushtetues, sigurisë, qytetarëve, objekteve të kultit, infrastrukturës strategjike etj.

(Sqarim: neutralizim do të thotë paaftësim për të vepruar. Rast ilustrimi "Kumanova", ku me datën 09/05/2015 disa burra shqiptarë, të pakënaqur me sjelljen e pushtetit të Maqedonisë së Veriut, u organizua në kryengritje të armatosur. Ata u neutralizuan si grup, u vranë dhe u arrestuan të tjerët, nuk iu çel asnjë korridor humanitar, si në rastin e grupit ushtarak serb në veri më 24.07.2023).

E përgëzoi Policinë e Kosovës që përmbushi detyrat e veta që ia japin Kushtetuta dhe ligji, për aq sa iu mundësua, pa urdhra politike as operative, por sipas vlerësimit të situatës në terren. Kjo tregon se ata që e bën shtetin, jo vetëm që e pavarësuan, e zhvilluan në infrastrukturë e ekonomi, por i zhvilluan edhe kapacitetet e sistemit të sigurisë dhe mbrojtjes.

KFOR-i ka për detyrë t'i neutralizojë formacionet ushtarake e jo kushtetuese. Ky sukses i policisë tregon më së miri se parullat "20 vjet shkatërrim" paskan qenë propagandë mashtruese e Kurtit. Sot, pas kohës optimale për analizë, pas kaq orësh të gjendjes së luftës në Kosovë, me përgjegjësi kërkoj që menjëherë nga Komanda e Përgjithshme e NATO-s të bëhet përgjegjës gjenerali i KFOR-it për mospërmbushje të detyrave sipas mandatit që i jep KS/OKB në Kosovë, për mjedis të sigurt për shtetasit e Republikës së Kosovës dhe pacenueshmëri të kufijve, pra të pamundësojë infiltrimin e invazionin e trupave dhe armatimeve të Ushtrisë serbe në territorin e Kosovës.

KFOR-i e ka për detyrë t'i neutralizojë formacionet ushtarake e jo kushtetuese.

Është shkelur Rezoluta 1244, e cila është ambienti ndërkombëtar i vendosjes së lirisë dhe shtetësisë së Kosovës. Kjo flet për shkelje të krejt të drejtave dhe lirive njerëzore.

Po ashtu, kërkoj që oficeret e Policisë së Kosovës, që reaguan sipas vlerësimit të situatës, duhet të gradohen e të shpërblehen me medaljen shtetërore të trimërisë, sipas Kushtetutës.

### *Skenar i sinkronizuar i aktorëve në tryezën e dialogimit

Tani kanë filluar të kthjellen ujërat dhe qasja analitike pas veprimit po krijon shumë pikëpyetje e shtron set pyetjesh teknike profesionale, politike e diplomatike që e ndihmojnë analizën.

Të gjitha çojnë në konkludimin se ishte "skenar" mirë i sinkronizuar i të gjithë aktorëve që uleshin rreth tryezës së dialogut. Kjo mundësi eskalimi të dhunës ishte paralajmëruar shumë kohë më parë, nga lehtësuesi i dështuar në dialog, z. Lajçak.

Përgjegjësi kryesor për humbjen e jetës së policit është Albin Kurti, me moskoordinim dhe mosplanifikim me asnjërin nga faktorët e sigurisë shtetërore e ndërkombëtare në vend.

Mësimi i mësuar është se armiqësia me ShBA-në rrezikon jo vetëm jetën e një rreshteri, por të krejt shqiptarëve që jetojnë në Republikën e Kosovës.

Po qe se Qeveria e Kosovës paska qenë kaq vigjilente, si ka mundësi t'i fusin të gjitha ato kalibra armësh që u përdoren në luftën kundër Republikës së Kosovës, një arsenal për operim të një kompanie të këmbësorisë?

Si pati mundësi të infiltrohen në territor, e të pozicionohen në istikame luftimi edhe të mos vërehen as nga AKI-ja, as nga policia, as nga KFOR-i që ka njësi e teknologji elitare?

Është shqetësuese deklarata e ambasadorit të Amerikës, se "nuk kishim informacion se do ta parandalonim"!

Po presidentja, ku ndodhej? A arriti të jetë në kohën e duhur në Kosovë dhe ta marrë rolin që i takon si komandante supreme? A ishte në nivelin e detyrës? Meqë ndodhej në Amerikë kur mori njoftimin se ka invazion ushtarak në Kosovë nga Serbia, a mori instruksione se si duhet të veprojë, cilat duhet të jenë detyrat e saj pas kthimit dhe mbështetja nga SHBA-ja që është në Kosovë?! Tani kur edhe ndërmjetësi i dështuar i BE-së, z. Lajçak, e thotë nëpër dhëmb që duhet të kthehemi në tavolinën e bisedimeve. Ndërsa presidentja së fundmi u shfaq edhe më radikale duke kërkuar që të ulemi dhe ta shkruajmë draftin e Asociacionit. Po t'i shtojmë kësaj edhe hamendësimin e frikën e diplomatit amerikan, se ka rrezik të ketë sulme prapë, kjo mund të përkthehet edhe si, "nëse nuk e bëni draftin e asociacionit" në kohë reale.

Prandaj presidentja me formulën e mendësisë komuniste e regjimeve totalitare, atë të unitetit në mendime, i bashkoj krerët partiakë të Kosovës. Uniteti më i madh nacional ishte në vitet '90, por jo në mendime. Pluralizmi i mendimeve u zhvillua edhe në ato rrethana të unitetit të domosdoshëm. Sikur presidenti Rugova të thoshte se mendimi e veprimi ndryshe jashtë vizionit të tij, është tradhti!?

Por, jo! Ai e promovoi e mbështeti pluralizmin partiak në mendim e veprim, ndaj lindi UÇK-ja dhe ndodhi lufta për çlirim. Prandaj, sot nuk duhet unitet komunist, por mendime që ofrojnë alternativën më të mirë për të gjetur zgjidhje që garanton integritetin e sovranitetin e vendit. Përndryshe, kjo është edhe zhdukja e opozitës në vizionin e tij.

### *Institucionet e Republikës së Kosovës duhet të dalin me raport të detajuar!

Si ushtarak me përvojë të gjatë në analizat e mbrojtjes dhe zhvillimin e skenarëve të luftës, pa e parë raportin zyrtar, shtetëror, rreth zhvillimit, sado që kam informata informale dhe direkt nga terreni, nuk mund të nxjerr dot përfundime, por po nxjerr konstatime që duan analizuar përmes pyetjeve teknike profesionale.

Të gjitha këto duhet të jepen përmes një raporti zyrtar, të cilit prirem t'i besoj.

Komisionit për Siguri e Mbrojtje duhet t'i raportohet me raport të

detajuar nga MPB-ja, drejtori i përgjithshëm i policisë dhe AKI-ja për tërë zhvillimin.
Është vrarë një efektiv policie e plagosur dy tjerë, dhe duhet raport balistik për armën, distancën, plagën etj.
Duhet sa më parë të mbahet mbledhje e Komisionit Parlamentar për Siguri e Mbrojtje për ta shqyrtuar planin e sigurisë kombëtare.
Këto analiza do të jepnin përgjigje në pyetjet indikative që eliminojnë çdo dilemë lidhur me zhvillimet e fundit në veri, por edhe pritjet dhe zhvillimet në rrugën përpara, në aspektin e sigurisë dhe atë politik.

## *Objektivat praktike që pritet të arrihen

Cilat ishin objektivat politike të këtij zhvillimi ushtarak në veri të vendit me ndërhyrjen nga Serbia?
– A është synim forcimi i pozitës së Kurtit?!
– Rehabilitimi i dështimit në diplomaci të ndërmjetësve evropianë, dhe lirimi nga presioni për ta bërë asociacionin?!
– Të blejnë kohë për mosbërjen e tij dhe t'i sigurojnë edhe një mandat Kurtit në pushtet, dhe atë në momentet më kritike të vendimmarrjes politike që priten për Kosovën?!
Me këto veprime dështuan projektin amerikan për Kosovën, pa asnjë pasojë për ndërmjetësit dhe pushtetarët, duke ia "hedhur paq" me skenarin "infiltrimi i grupit terrorist"!
Prandaj kam kërkuar hetim për tërë procesin e dialogut, nga inteligjenca dhe Kongresi amerikan.

## *Ideimi i skenarit, deklaratat dhe zhvillimet mbështetëse

Tanimë s'ka dilema se kjo çfarë ndodhi në veri është planifikuar e organizuar në takimin e Berdo-Brioneve dhe atë të Greqisë.
Kjo shpjegohet edhe me faktin se asnjë serb nuk reagoi, as nuk u implikuan, as nuk protestoi. Kujtojini radhët e kaluara si ka funksionuar kjo.
Vuçiqi në protestat e kaluara, kur u sulmuan trupat e KFOR-it, urdhëroi dislokimin e trupave ushtarake në kufijtë e Kosovës. Kësaj radhe heshti!
Në orën 14:00 zëdhënësi i tij paralajmëroi se do t'u drejtohet medieve në ora 20:00, koincidencialisht mu në kohën kur edhe u përfundua skenari "infiltrimi i grupit terrorist".
Deklarata e Vuçiqit e shfaqi atë të relaksuar dhe nuk bëri asnjë sulm ndaj institucioneve të vendit. Thjesht e interpretoi si reagim i rebeluar i disa qytetarëve të pakënaqur, dhe vra një qytetar serb i Kosovës!
Por, me të drejtë shtrohet pyetja, ku u rrit, ku u stërvit ky grup etj?. Andaj Serbia nuk i bëri reagimet e zakonshme.
Kurse faturimi i përgjegjësisë Kurtit është për rritje të përkrahjes për të në popull.
Çështje të tjera që duhen zbardhur janë edhe tri përgjigje, që i kërkoj si ushtarak në këtë situatë:
Si ka mundësi që Dioqeza e Prizrenit sapo nisi sulmi i forcave të xhandarmërisë serbe dhe organizatave terroriste atje, ndaj policisë dhe rendit kushtetues të Republikës së Kosovës u distancua nga manastiri i Bajskës?
Si nuk u ndez asnjë sirenë alarmi në Mitrovicën e Veriut edhe përkundër 12 orë luftimesh të zhvilluara bash në fshatin me numrin më të madh të popullsisë serbe?
Vuçiqi në protestën e fundit të zhvilluar nga serbët në veri ku u plagosën 12 ushtarë të KFOR-it e nisi armatën e Serbisë drejt Kosovës, ndërsa kësaj radhe, edhe pas raportimit për vrasje të serbëve në luftë me Policinë e Kosovës, nuk dha asnjë urdhër për ushtrinë e tij të famshme!?

## *Rehabilitimi i Serbisë dhe Vuçiqit

"Zëdhënësi" i agresionit ushtarak serb në Kosovë, këshilltari i kryeministrit për negociatat, Surroi njoftoi edhe për pengje. Kjo u bë me qëllim që trupat e invaduara dhe armatimet e futura e strehuara në ambientet dhe objektet e manastirit në Banjskës, shumë kohë më parë, të cilësohen "grup terrorist" dhe t'iu krijohet hapësirë manovrimi operacional, meqë e pamundëson veprimin e Forcave policore të Kosovës.
Me cilësimin si grup terrorist, e rehabiliton Beogradin nga përgjegjësia, meqë kjo qeveri edhe ashtu i ka shpallur dy organizata të tilla.
Me këtë Vuçiqi nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi për sulm në territorin e shtetit të Kosovës!
Informata se trupat serbe që invaduan në veri, ishin të drejtuara nga Aleksandër Vulin – shef i Shërbimit Sekret Serb, aspak nuk e zbeh faktin se ky ishte një sulm i organizuar i trupave ushtarake të xhandarmërisë serbe, të urdhëruara nga Beogradi zyrtar.
Por, drejtimi nga Vulin dhe, po ashtu, në radhët e tyre ishin edhe personat që janë pjesë e strukturës politike serbe që përfaqësohet në Kuvendin e Kosovës. Ndërkohë bëhet e ditur se ka nga ta të plagosur, që janë në listën e zezë të ShBA-së dhe të shpallur terrorist nga qeveria Kosovës që po trajtohen në diskrecion, në Serbi.
Pra, kjo është pjesë e skenarit! Prandaj, skenaristët me një veprim e ndalën procesin e dialogimit të mbajnë ndezur një vatër krize diku në rajonin evropian, të blejnë kohë për status-quo, e cila është interes strategjik vetëm i Rusisë.
Edhe deklarimet e kryeministrit dhe zëvendësdrejtorit të përgjithshëm të Policisë së Kosovës në konferencë për shtyp teksa po ndodhte sulmi në veri i shërbyen teorisë së "grupit terrorist", me çka e amnistuan presidentin serb nga penalizmi ndërkombëtar për ndërhyrje ushtarake në territorin e Kosovës.
Po ashtu, ndërsjellës kjo duhet parë edhe si qëllimi i rehabilitimit dhe kreditim të Kurtit e Viçiqit, për riinstalim në pushtet në të ardhmen e afërt zgjedhore, në emër të luftimit të grupeve të shpallura terroriste.
Pra, siç e thash, fillimisht u pa si një projekt për të fituar kohë që të mos e krijojnë asociacionin, si detyrim nga marrëveshjet në Bruksel e Ohër, edhe përmes këtij refuzimi, të blihet edhe një mandat për qeverisje të Albinit, në emër të pseudopatriotizmit patetik.
Por, dalja e presidentes supreme (në kuptimin e kohës rekorde për të cilën u kthye nga ShBA, brenda pak orësh, po thuajse njëkohësisht me kryeministrin që u kthye nga zgjedhjet në Zvicër), me qëndrimin se duhet të bëhet asociacioni, e ndryshon kursin e vlerësimit. Takimi me kryetarët e subjekteve parlamentare duket se ishte edhe informimi për detyrimin e krijimit të Asociacionit. Mbetet vetëm të shpresohet që të bëhet sipas germës së Kushtetutës së Kosovës.

## *Analogjitë operacionale - doktrinore të shërbimeve sekrete

Pa i krahasuar në mision, por si taktikë ngjan si dy pika uji me infiltrimin, e tradhtisë si në rastin e Kumanovës, por kjo në versionin serb, pati një skenar strikt, pa asnjë devijim nga misioni sekret.
Kjo vetvetiu nxitë pyetjen, pse heshti Stoltenberg, KOMKFOR, i cili ka përgjegjësi, ngase në ditën D, Kosova ka qenë jashtë kontrollit politik e ushtarak të KFOR?
Pra dallimi nga skenari Kumanova ishte se këtu planifikohej një depërtim me trupa, pajisje e armatim, njëjtë si ndërhyrja ruse në Donjetsk e Lohans në Ukrainë.
Kjo për faktin se, në manastir kishte armatim për armatosjen e një kompanie të këmbësorisë prej 200 pjesëtarësh.
Kur u futën ato? Nga çfarë drejtime, e si nuk vërehen nga vigjilenca kosovare?!
Po pretendohet se janë armë që kanë mbetur që nga lufta, atëherë si u bë që paskan qëndruar pa u identifikuar nga pushteti vendor atje dhe PUN?
Këto pretendime i demanton fakti se ishin armë dhe municione të mirëmbajtura.
Kishte armatime moderne si robotët luftëtarë të armatosur - një armë e re e Serbisë që e ka ekspozuar e testuar në ushtrimet e përbashkëta ushtarake me Forcat ruse pas lufte kur u ngrit baza ruse e Nishit dhe ajo në afërsi të kufirit me Kosovën, nga viti 2009;
Mortaja 60 e 82mm (të cilat nuk figurojnë në listën e armatimeve të kapura të policisë - pse?) që hyjnë në artilerinë e lehtë të këmbësorisë;
Automjete taktike të transformuar e veshura me blind;
Automjete jotaktike me shenja zyrtare identifikuese të KFOR-it (të cilat nuk figurojnë në listën e armatimeve të kapura të policisë - pse?);
Armë zjarri të këmbësorisë të të gjitha kalibrave nga pistoleta, pushkë automatike, mitraloz të lehtë e të rendë; mina kundër tank e kundër këmbësorisë (ofensive-MRUD), municione të të gjitha kalibrave.

## *Kisha serbe në rolin e saj historik doktrinar

Të gjitha këto të ruajtura në Manastirin e Banjskës dhe objektet e tij përcjellëse.
Shtrohet çështja se a ka shërbyer manastiri si bazë e armatimeve dhe grupeve ushtarake e terroriste për strehim e stërvitje?!
Cili është roli i personelit kishtar aty?
A ka terroristë ushtarakë që kamuflohen nën petkun fetar?
Si kanë reaguar deri me sot?
Cili duhet të jetë roli i kishave dhe manastireve sipas kanoneve kishtare, ligjeve dhe Kushtetutës së Kosovës?
Po nëse kalojnë si "prona të Serbisë" kjo trashëgimi fetare ortodokse e jona, kisha e manastire, sipas vendimit të gjykatës e negociatave, pastaj edhe me status eksterritorialiteti sipas pikës shtatë të planit franko-gjerman, i marrëveshjes së Brukselit e Ohrit për çka do të shërbejnë?!
Çka atëherë, kur edhe s'mund të kemi qasje kontrolli si shtet?
Po çfarë nëse edhe xhamitë na kthehen në baza të grupeve ekstreme fetare?
Ku do të përfundojmë si shoqëri e shtet?
Asaj që i jam frikuar shumë është se ky aksion ka mundur të realizohet në Kosovën Lindore.
Atje do i kishte dëmtuar shqiptarët, duke provokuar largimin masovik të tyre, të cilëve edhe ashtu po iu shuhen adresat, identiteti autokton në atë trevë e po ju tjetërsohen pronat.

## *Skenari "infiltrimi i grupit terrorist, skenar i ndaluar, po i papërfunduar"

Tani thjesht ngre një shqetësim, se Serbia dhe grupi kriminal i xhandarmërisë, pjesëtarë të organizatave terroristë të shpallura nga Qeveria Kosovës, mund të hakmerren, duke pretenduar të sulmojnë me armë të goditjes në distancë, dhe të arsyetohen se prapë sulmin e kanë kryer grupi terrorist. Çka nuk e bën përgjegjëse drejtpërdrejtë Serbinë e Vuçiqin.
Unë i bej thirrje KFOR dhe Shtetit që ka nën kompetencë hapësirën ajrore të Kosovës, të jenë në gjendje gatishmërie, pasi që sipas informacioneve, Brigada parashutiste e Forcave të Armatosura të Serbisë është dislokuar në afërsi të Kosovës, në zonën e Rashkës.
Se kjo nuk mund t'i faturohet zhvillimeve që po cilësohen si terroriste, etj., flet po ashtu reagimi në sinkron i shumë qarqeve politike me zë në Ballkan dhe Evropë, me idenë e një "konference ndërkombëtare" një "mini-Dejtoni" etj.
Republika e Kosovës, tashmë e ka bërë zgjidhjen politike me pavarësinë, të cilën e ka të njohur nga bota, me theks ShBA-ja në kufijtë aktual.
Dialogu është rruga e normalizimit duke marr obligime ndërkombëtare kontraktuale.
Në kohën e demarkimit është pranua se kufijtë e Kosovës janë në flamurin e saj.
Serbia i ka pranua këta kufij, kur pas marrëveshjes së Kumanovës, i ka tërhequr forcat nga vija kufitare, 5 km të hapësirës tokësore, plus 25 km të hapësirës ajrore.
Kjo ka ardhur si rezultat, se ka negociuar NATO-ja, përndryshe si shqiptar në të drejtën historike unë kisha kërkuar që kufiri të jetë për "gur të shpuar", kisha kërkuar që Republikës së Kosovës t'i bashkëngjitet edhe Kosova Lindore që është më shumë rëndësi sa Çamëria në jug të Shqipërisë.
Por, sot Kosova duhet të njihet në këta kufij.
Kërkimi i një "Dejtoni të ri" është mohim i kësaj që është arritur.
Kosova s'e njeh askënd tjetër si ndërmjetës përveç ShBA-në.

## *Përmbyllja e dialogut dhe konsolidimi i shtetit të Kosovës

Nuk ka nevojë të diskutohen kufijtë, por njohja e realitetit të ri nga Serbia, dhe njohja e Kosovës nga pesëshja evropiane dhe hapja e rrugës për integrime euroatlantike të sigurisë dhe zhvillimit ekonomik.
KFOR-i duhet t'i garantojë kufijtë e Kosovës që të mos depërtojnë trupat ushtarake as terroriste e të na i cenojnë manastiret dhe trashëgiminë ortodokse, në mbrojtjen tonë.
Nuk jam dakord as me idetë që po përpiqen të zënë vend në diskutimet publike për lëvizjen e kufijve. Aktualisht duhet ta stabilizojmë këtë Kosovë që po ndërtojmë. Kurse shqiptarët në trevat e tyre autoktone si në Kosovë Lindore, Rashkë e Sanxhak të krijojnë identitetin e vet shtetëror.
Por, edhe të jenë popull shtet formues në shtetet ku jetojnë në trevat e tyre autoktone, si Maqedonia e Veriut e Mali i Zi. Të kemi industri të mbrojtjes dhe të avancojmë me kapacitetet e FAK-ut.
Të mos trajtohemi me fusnota të UNMIK-ut, por të zhvillohemi si shtet stabil siç është shembull Luksemburgu.
Të afrohemi e lidhemi me Shqipërinë dhe shtetet përreth, ku komuniteti shqiptar autokton na shërben si urë lidhëse.

# Nusja që zemëroi Venedikun, pasi përdori një pirun

## Nga kockat dhe guaskat e kafshëve e deri te pirunët dhe shkopinjtë, historia e takëmeve ka qenë e mbushur me snobizëm dhe besëtytni …



Nga: Charles **SPENCER** / The *Telegraph*

Ia kem borxhli kardinalit Rishelie, këshilltarit kryesor të Luigjit XIII të Francës, që na dha thikën e tryezës. Mysafirët që përdornin kamat e veta në tryezë, atë e neveritnin. Kështu, më 1637 shpiku tehun e lakuar të thikës, me majë të topitur. Luigji XIV e miratoi këtë përsosje.

Snobizmi prej kohësh ka qenë pjesë e ekuacionit të takëmeve, me thikat e peshkut si objekt i veçantë i përbuzjes: poema e Xhon Beçemanit, Si të sillesh në shoqëri, kritikon atë që cilësonte si sjellje të klasës së lartë. Këtë sulm ndaj "pecetave" dhe objekteve të tjera që i shihte si borgjeze, ai e hapte me:

Telefon për thikat e peshkut,
Norman,
Pasi kuzhinieri është paksa i nervozuar …

Por, rreth një shekull më parë, ishin të zakonshme takëmet e dizajnuara për një qëllim specifik. Titaniku u fundos në vitin 1912 bashkë me 1517 njerëz, por edhe 400 darë asparagusi, 100 gërshërë rrushi dhe 1000 pirunë për goca deti.

Si me tragjedinë, e njëjta edhe me fiksionin. Në një episod të Downton Abbey-it, shërbëtori Karson teston një shërbëtor praktikant me një sërë sendesh argjendi: shërbëtori identifikon lugët për çaj, vezët, pjeprin, reçelin dhe grejpfrutin, por ndalet te lugët e bujonit, të bëra për një tas më të vogël e që dallonin nga ato që përdoreshin për supën e rëndomtë.

Teksa lugët në një mënyrë janë përdorur për mijëra vjet – neandertalët përdorën kockat dhe guaskat e kafshëve si lugë, ndërsa Roma e lashtë përdorte ligulat për supa dhe ushqime të buta dhe koklerat më të forta për ushqimet e detit dhe vezët – piruni ka pasur një rrugëtim testues deri te pranimi.

Në vitin 1003, një nuse nga familja perandorake bizantine tmerroi Venedikun kur përdori një pirun pas martesës me djalin e dozhit. Shën Pjetër Damiani shkroi me neveri se ajo "shponte [ushqimin e saj] me një shtyllë të një instrument të caktuar të artë me dy degë, dhe kështu donte ta çonte në gojë". Kur më vonë ajo vdiq nga murtaja, këtë ai e shihte si fundin e saj të dhimbshëm, si hakmarrje të Zotit ndaj zgjedhjes së saj të papërshkrueshme të takëmeve.

Pirunët përfundimisht u bënë modë nën Katerina de' Mediqin. Gruaja e Henrit II të Francës dhe nënë e tre mbretërve të tjerë francezë, ishte njëra prej grave më të fuqishme në Evropën e shekullit XVI. Prika e saj përmbante pirunë të bërë nga Selini, nga argjendari i Rilindjes, të cilat mahnitën shikuesit. Disa breza më vonë, në 1633, Karli I i Anglisë deklaroi: "Është më mirë të përdorësh pirunin" dhe ia dha secilit prej fëmijëve të tij një thikë, një lugë dhe një pirun argjendi.

Shkopinjtë ndoshta filluan të përdoren 5000 vjet më parë, si degëza të dobishme për të hequr ushqimin nga tenxheret e avullit. Rreth vitit 400 p.e.s., mungesa lëndëve djegëse në Azi bëri që copat më të vogla të mishit të gatuheshin, pasi u duhej më pak kohë në flakë. Meqenëse një ushqim i tillë tashmë ishte prerë, nevojiteshin vetëm shkopinjtë për ta ngrënë – në Japoni, këto mund të bashkoheshin në maje duke vepruar si mashë.

Besëtytnitë rrethonin shkopinjtë: palët e pabarabarta besohej se prishnin aranzhimet tuaja të udhëtimit, ndërsa mbajtja e tyre shumë lart rrezikonte të vononte martesën.

Takëmi im i preferuar në [pallatin] Olthorp është një lugë që babai im përdorte çdo Krishtlindje, për të hequr qendrën kremoze të [djathit] stiltonit të tij. Pyes veten nëse e kalon testin e Beçemanit? /Telegrafi/

## KËNGË



Poezi nga: **Thomas STEARNS ELIOT**
*Përktheu: Maksim Rakipaj*

Nëse Koha dhe Hapësira, si thonë të Urtët,
janë gjëra që s'mund të ekzistojnë,
dielli që nuk cenohet nga ndryshimet
aspak nuk është më sipëror se ne.

Përse pra, e dashur, të shpresojmë
të jetojmë një shekull a më tej?
Flutura që jeton veçse një ditë
ka jetuar përjetësinë.

Lulet që të dhashë kur vesa
fërgëllonte në degën kacavjerrëse,
para se bleta të shkonte të thithte
trëndafil i egër qe tharë.

Të ngutemi pra, të marrim sa më shumë
pa u trishtuar nëse vyshken më pas;
të pakta janë ditët e dashurisë sonë:
të paktën t'i bëjmë hyjnore.




# Sport


Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

# Prishtina barazon me Dukagjinin, Drita mposhti Feronikelin '74

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 28 SHTATOR - Dy ndeshjet e fundit të javës së 7-të në Superligën e Kosovës në futboll janë zhvilluar të enjten, ku Prishtina luajti baras me Dukagjinin, derisa Drita mori tri pikë ndaj Feronikekit '74. Skuadra e Prishtinës ka ndarë pikët me Dukagjinin, pasi të enjten kanë luajtur me rezultat 2-2. Kryeqytetasit e nisën më mirë ndeshjen dhe arritën të kalojnë në epërsi në minutën e 22-të, kur Krasniqi shënoi nga pika e bardhë. Tetë minuta me vonë skuadra nga Klina rikthehet në lojë, falë autogolit të Mujës. Në fund të pjesës së parë, Basri i Dukagjinit shënon autogol dhe kryeqytetasit shkojnë në pushim me epërsi të një goli (2-1). Në pjesën e dytë rastet nuk munguan, por u shënua vetëm një gol nga Altin Merlaku, që vulosi rezultatin final 2-2. Pas kësaj ndeshje, Prishtina ngritët në pozitën e katërt me 10 pikë e në anën tjetër Dukagjini zë vendin e gjashtë me 7 pikë. Fitore shumë të rëndësishme në garën për kreun e tabelës ka regjistruar Drita nga Gjilani, pasi e mposhti Feronikelin '74 me rezultat 0-2. Në minutën e 34-të, Drita kalo në epërsi me golin që shënoi Krasniqi pas asistimit të Thaqit. Golin e dytë mysafirët e shënuan në minutën e 77-të, kur Besnik Krasniqi realizoi nga penalltia. Pas tri pikëve, gjilanasit janë në vendin e tretë me 12 pikë të grumbulluara, derisa "Nikli" zë vendin e parafundit me vetëm 6 pikë. Ndërsa të mërkurën skuadra e Llapit ka bërë rikthim sensacional në ndeshjen ndaj Malishevës, të cilën e fitoi me rezultat 2-3. Vendasit avancuan me dy gola epërsi, por ishin mysafirët që nuk u dorëzuan dhe fitoren e siguruar në minutat shtesë. Fitore të mërkurën kanë regjistruar edhe Ballkani dhe Gjilani në përballje me Fushë Kosovën, përkatësisht Lirinë. Kampionët e Ballkanit e mposhtën Fushë Kosovën me rezultat 2-0, kurse skuadra e Gjilanit e fitoi me rezultat përballjen me Lirinë (1-0).



**SUPERLIGA**

| | |
|---|---|
| Prishtina - Dukagjini | 2-2 |
| Feronmikeli '74 - Drita | 0-2 |
| Fushë Kosova - Ballkani | 0-2 |
| Gjilani - Liria | 1-0 |
| Malisheva - Llapi | 2-3 |

**Tabela**

| | | Pikë |
|---|---|---|
| 1. Llapi | 7 | 16 |
| 2. Ballkani | 6 | 16 |
| 3. Drita | 6 | 12 |
| 4. Prishtina | 7 | 10 |
| 5. Gjilani | 6 | 7 |
| 6. Dukagjini | 7 | 7 |
| 7. Liria | 7 | 6 |
| 8. Dukagjini | 7 | 6 |
| 9. Feronikeli '74 | 7 | 6 |
| 10. Fushë Kosova | 6 | 1 |

# FFK-ja: Shqetësues mosreagimi i Federatës së Greqisë për pankartat shoviniste në ndeshjen Olympiakos - Aris

"Epoka e re"

PRISHTINË, 28 SHTATOR - Federata e Futbollit e Kosovës e ka dënuar me ashpërsi incidentin dhe fyerjen e rëndë të natyrës shoviniste që ndodhi në stadiumin "Karaiskakis", në ndeshjen e kampionatit grek mes Olympiakosit dhe Arisit, që u zhvillua të mërkurën në mbrëmje. "Shfaqja e pankartave kundër Kosovës dhe lavdërimi i grupit të terroristëve që pak ditë më parë kryen agresion ndaj shtetit të Kosovës është një shkelje e rëndë e vlerave të futbollit dhe shprehje e gjuhës së urrejtjes mes popujve. Ky incident është i papranueshëm dhe nuk ka vend në botën e futbollit", thuhet fillimisht në reagimin e FFK-së. Federata e Futbollit e Kosovës është shprehur e vetëdijshme për lidhjen e fuqishme të grupit të tifozëve të Olympiakosit me grupet radikale të tifozëve në Serbi, edhe për faktin se disa prej tyre janë serbë të infiltruar në këtë grup: "Megjithatë, jemi të indinjuar nga mungesa e reagimit të Federatës Greke të Futbollit për t'u përballur me këtë situatë. Lejimi i këtyre pankartave fashiste e raciste në tribunat prapa portës gjatë gjithë ndeshjes është një mospërgjegjësi që nuk mund të tolerohet". Kosova e konsideron Greqinë si një shtet mik dhe vlerëson qasjen e saj pozitive karshi Kosovës në marrëdhëniet ndërkombëtare, por ka kërkuar nga autoritetet e futbollit në Greqi të jenë të kujdesshme ndaj rasteve



të tilla: "të ndjekin me përgjegjësi protokollin e UEFA-s dhe të ndëshkojnë incidentet e tilla në mënyrë adekuate". Federata e Futbollit e Kosovës është zotuar se do të vazhdojë të ndërtojë ura miqësie dhe bashkëpunimi në futboll dhe nuk do të lejojë që të ashtuquajturit tifozë ta keqpërdorin këtë sport me ngjyra raciste. "Ne kërkojmë nga UEFA që të angazhohet edhe më fuqishëm në luftën kundër diskriminimit në të gjitha stadiumet dhe të sigurojë që futbolli të mbetet një burim argëtimi dhe bashkëpunimi për të gjithë, duke ndihmuar kësisoj në mbrojtjen e vlerave ndërmjet popujve", përfundon reagimi i FFK-së.

# Istogu për herë të shtatë në gara evropiane, Ferizaj kërkon suksesin e parë evropian

Istog, 28 shtator - Kampioni i Kosovës në hendboll, KHF Istogu, për herë të shtatë rresht do të paraqitet në gara evropiane. Istogaset në kompeticionet kontinentale kanë debutuar në edicionin 2017/18, atëbotë në Challenge Cup. Në edicionin 2018/19 të Challenge Cup e kaluan me sukses kundërshtarin e parë, skuadrën italiane Cassano Magnago. Në edicionin 2020/2021 të Kupës Evropiane, Istogu fillimisht e eliminoi Vushtrrinë. Më pas, në raundin e tretë, luajti dy ndeshje të forta me skuadrën bjelloruse Victoria Berestie. Të parën e fitoi 33:30, por në ndeshjen e dytë i mungoi fati dhe pësoi 32:28. Fundi ishte dramatik, por Istogu nuk avancoi. Vjet Istogu u eliminua nga Çairi i Shkupit, ndërsa në fundjavë përballë do ta ketë skuadrën nga Portugalia, SIR 1Maio/ADA CJB. Istogu garon në raundin e dytë të Kupës Evropiane (EHF European Cup) dhe të dy ndeshjet zhvillohen në palestrën "Karagaçi" në Pejë. Istogu është detyruar të zhvendoset në Pejë për shkak se palestra në Istog



është dëmtuar shumë. Është pritur që të rinovohet gjatë verës, por kjo nuk ka ndodhur për fat të keq. Ndeshjet e Istogut janë të shtunën e të dielën prej orës 18:00. Istogu synon tjetër sukses në garat evropiane. I themeluar në vitin 2018, Klubi i Hendbollit Ferizaj për herë të katërt paraqitet në gara evropiane. Por për herë të parë ferizajaset do të luajnë ndeshje evropiane para tifozëve të vet. Në tri paraqitjet e deritashme Ferizajt i ka munguar suksesi. Ka vetëm humbje në kuadër të Kupës Evropiane. Të gjashtë ndeshjet i ka zhvilluar në udhëtim, ndërsa i ka munguar edhe fati në short për të pretenduar më shumë. Në vitin 2020, Ferizaj u eliminua nga skuadra turke Muratpasha Belediyesi. Në vitin 2021 u ndal nga skuadra holandeze JuRo Unirek. Vjet e kishte përballë skuadrën polake, Gminy Kobierzyce dhe pësoi në të dy përballjet në Poloni. Në fundjavë në palestrën "Bill Clinton", Ferizaj i luan dy ndeshje me skuadrën izraelite Maccabi Arazim Ramat gan. Ndeshja e parë është të shtunën prej orës 20:15, e dyta të dielën prej orës 19:00. Ferizaj ka bërë ndryshime të shumta në përbërje dhe shpreson në suksesin e parë evropian. Kalimi i ekipit izraelit do të ishte sukses historik për skuadrën ferizajase.

## Ndërron jetë ish-futbollisti dhe trajneri i mirënjohur Ilaz Sina

PRISHTINË, 28 SHTATOR - Në moshën 88-vjeçare ka ndërruar jetë ish-futbollisti dhe ish-trajneri i mirënjohur nga Gjakova, Ilaz Sina. Lajmin për vdekjen e tij e ka dhënë skuadra e Prishtinës. "Ish-futbollisti dhe trajneri i mirënjohur nga Gjakova, Iliaz Sina, ka ndërruar jetë. Sina ka qenë udhërrëfyes për futbollistë, trajnerë e gjenerata të futbollit kosovar me dekada. Ai ka qenë trajner për një periudhë edhe te FC Prishtina (gjeneratat e reja). Klubi jonë i shpreh ngushëllimet më të sinqerta familjes Sina, miqve të tij dhe mbarë komunitetit të futbollit. Kujtimi i tij në historinë e futbollit shqiptar do të mbetet i paharruar. U prehtë në paqe!", thuhet në njoftimin e FC Prishtina.
Familja e Ilaz Sinës ka njoftuar se varrimi i të ndjerit do të bëhet të shtunën pasdite në varrezat e qytetit të Gjakovës.



## Bajrami: Jemi të parët që mposhtëm Interin



SASSUOLO, 28 SHTATOR - Goli i parë sezonal në Serinë A për fantazistin e kombëtares shqiptare dhe të Sassuolos, Nedim Bajrami, erdhi pikërisht ndaj Interit në "San Siro, ku Interi u mposht me përmbysje me shifrat 1-2, e para për këtë sezon. Pas përfundimit të sfidës, talenti shqiptar nuk e fshehu kënaqësinë për golin dhe fitoren, teksa foli edhe për rolin e tij në fushë. "Jemi shumë të lumtur, pasi kemi fituar dhe jemi të parët që mposhtim Interin këtë sezon. Jemi skuadër shumë e mirë. Dimë të luajmë me topin dhe duhet të vazhdojmë kështu. Ndihem mirë si fantazist dhe mendoj se këtu jap më të mirën time. Jam i lumtur që trajneri po më aktivizon në rolin tim të pëlqyer", ka thënë Bajrami.

# Gjimshiti: Nuk kemi kohë të mendojmë për fitore, na presin sfida të vështira



